



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 32 regjistër (JR)
Datë 09.07.2019

Nr. 29 i vendimit
Datë 09.11.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.11.2020, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e juridiksionit të rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Edison Ademi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi.

BAZA LIGJORE: Kreu VIII, nenet 62, 63, 64, 65 e 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 137, datë 09.04.2019, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të gremës “c” të pikës 1 të nenit 58, referuar nenit 61, pikave 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, me detyrë prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, pasi arriti në konkluzionet përfundimtare se subjekti i rivlerësimit Edison Ademi:
 - a) ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhim, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës;
 - b) në vlerësimin tërësor të rrethanave, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit Edison Ademi, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit ushtronte funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, që parashikon se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
3. Më parë, pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit (*vetting*) pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), rezulton se ky i fundit, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka përgatitur raportin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, ka arritur në përfundimet se:
 - a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) ka kryer deklaram të rremë; dhe
 - d) subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se kjo e fundit ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Edison Ademi.

II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit, brenda afatit ligjor¹, paraqiti ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit Edison Ademi (në

¹ Neni 63 i ligjit nr. 84/2016: “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliteve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet

vijim “subjekti i rivlerësimit”), i cili ka kërkuar kalimin e gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, hetimin administrativ për të tre komponentët, përfshirë vlerësimin e komponentit të figurës, duke u konsideruar “në nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”, si dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, dhe konfirmimin e tij në detyrë, bazuar në nenet 58, pika 1, germa “a” dhe 59 të ligjit nr. 84/2016.

6. Para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, fillimisht me *e-mail*-in e datës 24.10.2020 dhe më pas me zarfin postar të datës 28.10.2020, në funksion të shkaqeve të ankimit, sipas rregullave ligjore², subjekti i rivlerësimit ka dërguar parashtrimet e tij në Kolegj, nëpërmjet të cilave ka referuar edhe në disa akte shkresore.
7. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet parashtrimeve, ka kërkuar përkatësisht: i) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes që konkludoi me vendimin nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ii) hetimin administrativ për të tre komponentët, duke përfshirë edhe vlerësimin e figurës, si dhe duke u konsideruar “në nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”; iii) ndryshimin e vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 66/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016; si dhe konfirmimin në detyrën e prokurorit të z. Edison Ademi, bazuar në nenet 58/1, shkronja “a” dhe 59 të ligjit nr. 84/2016.

7.1 Gjithashtu, në parashtrime, subjekti i rivlerësimit pretendon se Kolegji, në procesin e rivlerësimit, përveçse disponon të drejtën për të vendosur sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si gjykatë e nivelit kushtetues, mbi bazën e legjislacionit aktual dhe praktikës gjyqësore, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, ka brenda tagrit të tij dhe mundësinë për të disponuar me lloje të tjera vendimesh, përveç atyre që shprehen në mënyrë eksplicite në ligjin nr. 84/2016. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit kërkon të merren parasysh dhe pretendimet për: i) shpalljen të pavlefshëm të vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përfshi hetimin administrativ mbi të cilin vendimi është bazuar; ii) pushimin e çështjes për shkak të pamundësisë së shqyrtimit të saj; ose iii) pezullimin e procesit të rivlerësimit deri në plotësimin e kuadrit ligjor, ndërtimin dhe veprimin e personit juridik kompetent, si dhe zgjidhjen nga praktika gjyqësore kombëtare e ndërkombëtare. Këto pretendime, sipas subjektit të rivlerësimit, paraqiten në kuptim të zgjidhjes së drejtë, brenda një procesi ku interesi publik është maksimal.

7.2 Sipas subjektit të rivlerësimit, anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit duhet të deklarojnë mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

8. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit, ka paraqitur shkaqet e ankimit me natyrë procedurale dhe lidhur me procesin e rregullt ligjor, si më poshtë.

pranë Komisionit që ka dhënë vendimin, sipas nenit 46 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Rregullat për ankimin administrativ, parashikuar në nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative, nuk zbatohen”.

² Neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

8.1 Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, çdo gjë e ka kërkuar me urgjencë, ndërsa vetë sillej me një komunikim tej çdo etike apo normaliteti administrativ, në mënyrë denigruese dhe me qëllime antiligjore të paramenduara.

8.2 Komisionerja Genta Bungo (Tafa) ka ushtruar funksionin në gjendjen e konfliktit të interesit. Sipas tij, deklarata e komisioneres Genta Bungo (Tafa) për mosqenien në konflikt interesi, nuk kishte datë dhe ishte e falsifikuar. Kjo komisionere, sipas subjektit të rivlerësimit, kishte cenuar edhe shortin me veprime të paligjshme, dhe gjithashtu kishte ndikuar te relatorja e çështjes dhe tek anëtari tjetër i trupit gjykues të Komisionit.

8.3 Mospajjsja me raportin e plotë paraprak të DSIK-së, në formën e dokumentit zyrtar³, dhe mbyllja e hetimit administrativ paraprak për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë profesional, përbën, sipas subjekti të rivlerësimit, shkelje të rëndë, e cila vijon edhe në marrjen e vendimit pa u mbyllur hetimi administrativ dhe pa u vlerësuar provat e paraqitura prej tij.

8.4 Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kërkesat për prova, të paraqitura me *e-mail*, dhe shkresën e datës 16.04.2019 të subjektit të rivlerësimit, i cili ka theksuar se është lajthitje e rëndë logjike dhe juridike vlerësimi i Komisionit se ai shfaq mungesë të etikës profesionale pas shpalljes së vendimit.

8.5 Komisioni ka aplikuar në mënyrë tendencioze barrën e provës, në afate të shkurtra, tej çdo etike dhe në kundërshtim me ligjin, duke e detyruar atë të ribëjë pothuajse të gjithë dokumentacionin. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se ai është përpjekur të sigurojë sa të mundej të dhëna, pasi në referim të kujtesës së tij, ishte gati e pamundur që saktësitë të ishin optimale për të gjitha arsyet njerëzore, sipas tij.

8.6 Procedimi disiplinor i gjyqtarëve dhe prokurorëve është i ngjashëm me një procedim penal dhe, në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, asnjë provë nuk duhet të ketë vlerë të paracaktuar, por duhet të vlerësohet në unitet me provat e tjera dhe duhet të debatohet në respektim të parimit të kontradiktoritetit.

9. Në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, si më poshtë.

9.1 Lidhur me pasurinë apartament 130 m², në lagjen “{***}”, Vlorë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk i ka llogaritur të ardhurat prej 1000.000 lekësh, me burim të pretenduar nga shitja e apartamentit në lagjen “{***}”, Vlorë, në vitin 2000, si dhe të orendive të këtij apartamenti. Shuma prej 8000 GBP, që subjekti i rivlerësimit pretendon se i ishte kthyer nga vëllai, z. A.A., në vitin 2004, ishte e njëjtë me shumën prej 8400 USD, burimi i së cilës ishte kredia në {***} Bank, të cilën subjekti i rivlerësimit pretendonte se ia kishte dërguar vëllait në vitin 2003, ndaj si e tillë, kjo shumë nuk mund të deklarohet dy herë. Mbi këtë bazë, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se kishte bërë deklaram të pasaktë dhe e kishte fshehur këtë shumë.

9.2 Lidhur me sendet dhe mobilet në vlerën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për efekt të deklarimit, ai ka dorëzuar kontratën e kredisë me {***} Bank, me vlerë 700.000 lekë, duke theksuar se gjendemi para një procesi dhe jo analize deklarate. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo shumë nuk është përfshirë në

³ Me datë e numër protokolli, me personat nënshkrues konkretë, por që i është dërguar vetëm me *e-mail*.

analizën financiare të Komisionit, duke pretenduar gjithashtu se Komisioni kishte bërë një shpërndarje subjektive të vlerave të arredimit, pa iu referuar në mënyrë korrekte shpjegimeve të tij.

9.3 Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk duhej të përfshihej si shpenzim vlera prej 800.000 lekësh, për blerjen e automjetit Mercedes Benz E270, me targë {***}⁴, sepse ai ishte dhurim nga vëllai, z. A.A. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ai ka vërtetuar të ardhurat e vëllait, z. A.A., në emigracion edhe për vitet 2004 - 2015. Gjithashtu, në analizën financiare, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të llogariteshin diferencat pozitive për çdo vit të mbartura në vitin pasardhës, duhet të përfshiheshin interesat e depozitave bankare dhe shpenzimet e jetesës duhet të llogariteshin sipas certifikatës familjare në vitin përkatës.

9.4 Nuk rezulton, sipas subjektit të rivlerësimit, asnjë përlogaritje për deklaram më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë që të mund të për afrojë minimalisht vendimmarrjen për shkarkimin e tij.

9.5 Duke kundërshtuar konstatimin e Komisionit për deklaram të rremë nga vëllai i tij, z. A.A., subjekti i rivlerësimit pretendon se në kuptim të ligjit dhe udhëzimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, ka një trajtim të veçantë ligjor për personat emigrantë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në kuptim të pasurisë veçmas për vëllain e tij, z. A.A., pasuri janë ato që kanë lidhje me pasurinë e tij dhe marrëdhënie të tjera në kuadër të legjislacionit shqiptar dhe jo atij anglez. Sipas subjektit të rivlerësimit, deklarata e rreme e pasurisë bëhet me dashje dhe vetëm për pasuritë e deklaruara të cilat janë fituar nga burime të paligjshme.

10. Në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të vlerësimit në tërësi të çështjes, si më poshtë.

10.1 Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka mbivendosur në mënyrë alogjike paragrafët 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas tij, të njëjtat fakte të pretenduara, përveçse të pavërteta, nuk mund të kenë përcaktime juridike të ndryshme. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka shkelur në mënyrë flagrante ligjin, parashikimet e nenit 61 në interpretim logjik, pasi është ndodhur në dy situata njëherësh, në kundërshtim me nenin 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pa përmendur asnjë ligj dhe dispozitë tjetër referuese.

10.2 Për sa i përket faktit të marrjes me qira nga {***}, Bashkia Vlorë, të tokës bujqësore në fshatin {***}, Vlorë, sipas kontratës së qirasë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka asnjë konflikt ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të tij në ushtrimin e funksionit, pasi sipas tij, nuk ka praktikisht asnjë mundësi që ai të trajtojë raste me natyrë penale apo civile që lidhen me autoritetin qiradhënës apo rastin, dhe as nuk ka ndodhur të ketë pasur trajtime apo veprime preferenciale. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka tejkaluar çdo lloj hapësire duke analizuar përmbajtjen e marrëdhënies juridiko-civile për marrjen me qira të tokës nga Komuna {***} Vlorë, dhe se nuk ekziston ende interesi, përfitimi, mënyra e prishjes së kontratës afatgjatë.

10.3 Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka manifestuar lajthitje të rëndë juridike kur ka arsyetuar se njohja me z. F.D. ishte shkak ligjor për të lënë dosjen, duke vijuar se komunikimi me z.

⁴ Të këmbyer me automjetin Mercedes Benz, me targa {***}.

F.D. kishte largësi kohore dhe ishte jashtë periudhës së rivlerësimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka sajuar hapur, pasi ai ka udhëtuar në Kosovë me z. E.M. në vitin 2014 dhe jo në vitin 2016, që z. E.M. rezulton të ketë qenë dënuar disa herë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se rrethanat e njohjes me z. E.M. janë jashtë periudhës së rivlerësimit dhe nuk kanë asnjë lidhje me kriterin profesional.

11. Së bashku me ankimin dhe kërkesën për kalimin në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës edhe disa dokumente, për të cilat kërkonte nga Kolegji që të debatoheshin në seancë gjyqësore publike, përkatësisht si më poshtë.

11.1 Vendimin nr. {***}, datë 12.02.2019, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër (në vijim “GjAGj”), dhe kërkesën e datës 09.10.2018 të prokurorit Elidon Hysenaj, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë (në vijim “PPGjShPS”), me qëllim për të vërtetuar gjendjen e konfliktit të interesit të komisioneres Genta Bungo (Tafa).

11.2 Për pjesën që i përket komponentit të figurës, subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka paraqitur disa komunikime elektronike me DSIK-në, si dhe raportin e DSIK-së që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi.

11.3 Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe kërkesën e datës 16.04.2019, të dërguar Komisionit, pas shpalljes së vendimit, për dijëni edhe ONM-së, Komisionit, Komisionerëve Publikë, Kolegjit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (në vijim “GjRrGj Gjirokastër”), si dhe kthim përgjigjen nr. {***} prot., datë 19.04.2019, të Komisionit.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Vlerësimi i Kolegjit para shqyrtimit gjyqësor të ankimit në themel

12. Juridiksioni i rivlerësimit dhe kompetenca e Kolegjit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, e cila parashikon: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese”, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar”.
13. Procesi gjyqësor në Kolegji zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”).
14. Kolegji fillimisht konstatoi se subjekti i rivlerësimit Edison Ademi legjitimohet për të ushtruar ankim në Kolegji në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i tij është depozituar brenda afatit ligjor.
15. Kolegji vlerësoi se debati gjyqësor në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, është i panevojshëm, pasi nga Kolegji vlerësohet se konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë e të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitej vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja.

15.1 Për sa u përket dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, sipas paragrafit 11 më sipër, Kolegji me vendim të ndërmjetëm vlerësoi të refuzonte marrjen e tyre në cilësinë e provave, si të panevojshme, dhe se fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen, bazuar në nenin 49, pika 6, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Kolegji, pasi verifikoi edhe përmbajtjen e dokumenteve të cilave u referohet subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, vlerësoi se ato nuk sjellin asnjë ndryshim të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, sipas nenit 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

16. Kolegji nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni, dhe nuk vlerësohet nga Kolegji se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision dhe, si rrjedhojë, nuk u konstatua se jemi para kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.
17. Kolegji vendosi të zhvillojë shqyrtimin e vendimit të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, mbi bazë dokumentesh, pasi vlerësoi kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Kolegjit i rezultoi se faktet dhe rrethanat lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurive, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të neneve 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b”, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ishin përcaktuese dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimmarrjen e Kolegjit, pa qenë e nevojshme që hetimi të shtrihej edhe në drejtim të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit. Kolegji e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit, pushimin e çështjes apo pezullimin e procesit të rivlerësimit. Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit duhet të deklarojnë mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, Kolegji e gjen gjithashtu të pabazuar, pasi juridiksioni kushtetues, me të cilin është pajisur Kolegji, sipas parashikimeve të nenit F, pika 3, fjalia e fundit e Aneksit të Kushtetutës, si i vetmi organ gjyqësor i procesit, nuk lejon që të vihen në dyshim parimet e kushtetutshmërisë, përfshirë edhe paanësinë e anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit, të cilët janë caktuar rregullisht me short për gjykimin e kësaj çështjeje, sipas procesit të rivlerësimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.
18. Kolegji vëren se gjatë hetimit administrativ, mbështetur në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”, Komisioni ka administruar raportet nga institucionet kompetente në lidhje me vlerësimet e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

18.1 Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 20.03.2018, vendosi të fillojë hetimin administrativ mbi procedurën e rivlerësimit. Në vijim, më datë 13.03.2019, me vendimin nr. 2, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Edison Ademi. Pas njoftimit të këtyre rezultateve subjektit të rivlerësimit në datën 15.03.2019, duke i kaluar edhe barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duke i dhënë të drejtën për njohjen me provat e administruara në përputhje me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative (në vijim “KPrAdministrative”), subjekti i rivlerësimit në datën 01.04.2019, ka dërguar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht pranë

Komisionit, si dhe disa kërkesa të cilat Komisionit i rezultuan të përsëritura dhe jo në funksion të marrjes së provave të reja, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

18.2 Seanca dëgjimore është zhvilluar në Komision më datë 05.04.2019, në prani të subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, i cili ka parashtruar shpjegimet përkatëse për rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe për procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

B. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet e ankimit për shkelje procedurale të Komisionit

- 19.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjatë hetimit administrativ nga Komisioni çdo gjë i kërkohej me urgjencë, tej çdo etike apo normaliteti administrativ, në mënyrë denigruese dhe me qëllime antiligjore të paramenduara, *Kolegji mori në shqyrtim pyetësorët dhe komunikimet e tjera gjatë procedurës së rivlerësimit në Komision.*

19.1. Kolegji vëren se në pyetësorët dhe komunikimet e tjera të Komisionit me subjektin e rivlerësimit, përkatësisht në datën 03.04.2018, datën 10.10.2018, datën 31.01.2019, datën 06.02.2019, datën 13.02.2019, dhe datën 06.03.2019, Komisioni ka zbatuar rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar të drejtën për kërkimin e provave për vetë subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka caktuar, rast pas rasti, edhe afatet brenda të cilave informacioni i kërkuar dhe që kishte lidhje me përcaktimin e rrethanave dhe fakteve të kësaj çështjeje, duhej t'i jepej Komisionit nga subjekti i rivlerësimit. Kolegji vëren se Komisioni me vendimin nr. 2, datë 13.03.2019⁵, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të jepte përgjigje, shpjegime apo prova brenda datës 26.03.2019, afat 11-ditor, i cili i vlerësuar në raport me rrethanat konkrete të çështjes, Kolegjit i rezultoi të ketë qenë i arsyeshëm që subjekti i rivlerësimit të ushtronte të drejtat e tij sipas ligjit. Sikurse rezultoi, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, dërguar me postë elektronike më datë 21.03.2019, Komisioni me vendimin nr. 3, datë 25.03.2019, ka shtyrë edhe me 3 ditë të tjera afatin për të dhënë shpjegime, e drejtë e cila rezultoi të jetë ushtruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.03.2019, sipas afatit të caktuar. Gjithashtu, në bazë të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vëren se Komisioni i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit se bashkëpunimi apo refuzimi për t'u përgjigjur, do të konsiderohej nga Komisioni në marrjen e vendimit. Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit është përgjigjur atëherë kur i është kërkuar nga Komisioni dhe se ai ka zbatuar me përpikëri afatet e caktuara nga Komisioni, duke dhënë shpjegimet dhe paraqitur provat përkatëse, qëndrim ky i mbajtur edhe nga vetë Komisioni⁶.

19.2. Për këto arsye, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, pasi institucionet e rivlerësimit janë të detyruara që të vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm dhe të arsyeshëm, sipas nenit 4, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe zbatimi i përcaktimeve ligjore nga ana e Komisionit, në funksion të shqyrtimit të shpejtë të çështjes, nuk rezultoi të ketë cenuar të drejtat e subjektit të rivlerësimit.

- 20.** Lidhur me pretendimin për gjendjen në konflikt interesi të komisioneres Genta Bungo (Tafa), Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në rrethanat e pretenduara të njohjes së kësaj komisionereje me një person të dënuar nga gjykata, kur ai ushtronte funksionin e drejtuesit të

⁵ Të njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 15.03.2019.

⁶ Shih paragrafin III, f. 5, të vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit.

PPGjShPS-së, me të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo komisionere ka pasur njohje familjare.

20.1. Kolegji vlerëson se edhe po të konsiderohet i vërtetë fakti se materialet e sekuestruara nuk i janë kthyer të dënuarit F.G. nga subjekti i rivlerësimit, si drejtues i kësaj prokurorie⁷ para se vendimi të merrte formë të prerë, por vetëm pasi u la në fuqi nga shkalla dytë e gjykimit, nga këto rrethana nuk do të rezultonin të provuara dyshimet se komisionerja Genta Bungo (Tafa) gjendej në situatë konflikti interesi me subjektin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 27, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

20.2. Kolegjit nuk i rezulton e provuar as që komisionerja Genta Tafa (Bungo) të ketë pasur lidhje të njohura të miqësisë me F.G., në kuptim të nenit 5, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Për familjarët e të dënuarit F.G., sidomos për babain e tij, subjekti i rivlerësimit parashtron se figurojnë me lidhje dhe njohje personale, prej zonave ku kanë banuar e banojnë, por dhe nga krushqitë mes tyre, përfshi ato që kanë me fqinjë a të njohur të familjes Bungo në lagjen e tyre të banimit në Lushnje⁸.

20.3. Kolegji vlerëson se, edhe nëse do të konsideroheshin të vërteta këto rrethana, ato nuk dëshmojnë gjendjen në konflikt interesi të komisioneres Genta Bungo (Tafa). Këto marrëdhënie të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohen si marrëdhënie të njohura të miqësisë apo të armiqësisë, në kuptim të nenit 5, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe të nenit 30, shkronja “b” e KPrAdministrative.

20.4. Kolegji vlerëson se pretendimet për gjendjen në konflikt interesi të komisioneres Genta Bungo (Tafa) nuk u provuan nga subjekti i rivlerësimit, çka bie ndesh me parimin e përfundimeve të bazuara në fakte, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016. Marrja e informacioneve nga publiku, siç pretendon ankuesi, por të pambështetura në prova, nuk përmbush kriterin e burimeve të njohura sipas nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe Kolegjit nuk i rezulton që informacionet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit të jenë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera.

20.5. Për këto arsye, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se komisionerja Genta Bungo (Tafa) gjendej në kushtet e konfliktit të interesit.

- 21.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se deklarata e komisioneres Genta Bungo (Tafa) nuk kishte datë, se kishte falsifikim duke cenuar edhe shortin, Kolegji vëren se në dosjen e Komisionit deklarata për konfliktin e interesit të komisioneres Genta Bungo (Tafa) mban datën 16.07.2018⁹, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të dosjes në datën 19.03.2019¹⁰, çka e bën të paqartë momentin e vendosjes së datës nga ana e komisioneres Genta Bungo (Tafa). Kolegji, gjithashtu, vëren se me *e-mail*-in e datës 13.02.2019, Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ishte vendosur rishpërndarja me short e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, për arsye shëndetësore, çështje të

⁷ Pra, para se vendimi i dënimit dhe i kthimit të mjeteve të sekuestruara të merrte formë të prerë dhe të ishte i ekzekutueshëm.

⁸ Përfshi zri. Genta Bungo (Tafa) dhe bashkëshortin e saj.

⁹ Shih f. 3094 të dosjes së Komisionit.

¹⁰ Shih f. 3132 të dosjes së Komisionit, megjithatë duhet theksuar se në materialet e skanuara të ardhura në Kolegji nga IKP-ja, deklarata e konfliktit të interesit të komisioneres Genta Bungo (Tafa) është pa datë.

cilat janë shortuar në datën 19.06.2018, sipas vendimit nr. 35, çka do të thotë se përkon data e nënshkrimit të deklaratës së konfliktit të interesit me rishpërndarjen e çështjeve në ngarkim të komisioneres që gjendej në pamundësi për të ushtruar funksionin.

21.1. Kolegji vlerëson se procedura administrative para Komisionit, është një procedurë dinamike, deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes dhe dorëzimit të dosjes, dhe për këtë arsye komisionerët, për aktet brenda kompetencave ligjore, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojnë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, sipas nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 112, pika 1 e KPrAdministrative¹¹.

21.2. Kolegji gjithashtu vlerëson se pavarësisht momentit të vendosjes së datës në deklaratën për konfliktin e interesit, nga ana e komisioneres Genta Bungo (Tafa), vendosja e datës pas nënshkrimit të deklaratës nuk ndikon në vlefshmërinë e procedurave të shortit, pasi ato janë dy akte të pavarura nga njëra-tjetra, dhe kompetenca për zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues i përket Mbledhjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe jo kryetares së saj, funksion që në këtë kohë e ushtronte znj. Genta Bungo (Tafa). Kolegji vëren se me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga procedura e shortit të zhvilluar nga Mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në mungesë të komisioneres Alma Faskaj, kishte vendosur të rishpërndante me short çështjet e komisioneres Alma Faskaj, për arsye shëndetësore të kësaj të fundit, dhe zëvendësimin e saj me komisioneren Genta Bungo (Tafa).

21.3. Për këto arsye, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se kishte falsitet në deklaratën e konfliktit të interesit të komisioneres Genta Bungo (Tafa) dhe se ishte cenuar shorti me të cilin ishte caktuar kjo komisionere në trupin gjykues të Komisionit.

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se anëtari tjetër i trupit gjykues të Komisionit dhe relatorja duhet të sqaronin sjelljen antiligjore të kryesueses së trupit gjykues, dhe pozicionin, neglizhencën apo nënshtrimin ndaj vullnetit të saj në çdo fazë të procesit, Kolegjit nuk i rezultoi e provuar që të jetë cenuar garantimi i paanësisë nga ana e kryesueses së trupit gjykues të Komisionit, sipas përcaktimeve të neneve 27 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016.

22.1 Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit, Kolegjit nuk i rezulton që anëtarët e tjerë apo vëzhguesi ndërkombëtar të kenë ngritur një pretendim të tillë në ngarkim të kryesueses Genta Bungo (Tafa), sikurse parashikon neni 17, pika 1, geramat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.

22.2 Për këto arsye, Kolegji gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo komisionere ka ndikuar në mënyrë të paligjshme tek anëtarët e tjerë të trupit gjykues të Komisionit, për dhënien e vendimit objekt shqyrtimi në Kolegji.

23. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk i është dhënë raporti i grupit të punës së DSIK-së, Kolegjit i rezulton që vendimi i Komisionit të jetë dhënë bazuar në përfundimet e arritura nga vlerësimi i pasurive dhe vlerësimi tërësor i procedurave, por jo bazuar edhe në përfundimet e arritura nga kontrolli i figurës¹², dhe për këtë arsye subjekti i rivlerësimit është pajisur me dokumentet e dosjes nga të cilat kanë rezultuar të dhëna dhe mbi të cilat është bazuar vendimi i Komisionit.

¹¹ Shih nenin 112, pika 1 e KPrAdministrative.

¹² Sipas konkluzioneve përfundimtare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit: ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhim, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës; në vlerësimin tërësor të rrethanave, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

23.1 Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk i janë dhënë sugjerimet, aktet, dokumentet, shkresat, përfshi përkthimin në gjuhë të huaj, që ishin përcjellë, si dhe kohën e përcjelljes së tyre tek ONM-ja apo vëzhguesit ndërkombëtar, deklarata, objeksione dhe sugjerim të vëzhguesit ndërkombëtar, Kolegjit i rezulton se në datën 19.03.2019, subjekti i rivlerësimit është paraqitur në Komision dha ka marrë në dorëzim të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij në CD, dhe i cili, sipas deklaratës së subjektit të rivlerësimit, ishte konform me dokumentacionin e dosjeve që i ishin vendosur në dispozicion¹³.

23.2 Për këto arsye, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk është pajisur me provat e nevojshme, pasi Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit është pajisur me ato dokumente që i kanë shërbyer procesit të tij të rivlerësimit.

- 24.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mbyllja e hetimit administrativ paraprak për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë profesional është në kundërshtim të hapur me ligjin sepse procesi dhe seanca duhet të kryhen për të tria kriteret, Kolegji vlerëson se Komisioni mund të bazojë vendimin edhe vetëm në një prej kriterëve të vlerësimit, pa dhënë zgjidhje përfundimtare në themel edhe për kriteret e tjera, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës rivlerësimi mund të kryhet edhe mbi bazën e një kriteri. Në kushtet kur konfirmimi në detyrë kërkon plotësimin me sukses të kontrollit në të tria kriteret¹⁴, ndërsa moskalimi me sukses i qoftë edhe njërit prej kriterëve është shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, hetimi për kriteret e tjera është i panevojshëm në dritën e efikasitetit të procesit dhe të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
- 25.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se përjashtimi si mundësi vendimmarrjeje e konfirmimit në detyrë, duke përfunduar hetimet vetëm për dy kriteret, pa nisur seanca dëgjimore, përbën shkelje të rëndë¹⁵, Kolegji sjell në vëmendje se mundësia e konfirmimit në detyrë vjen si pasojë e përmbyshjes bashkërisht të kushteve të arritjes së një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe kontrollit të figurës, dhe të një niveli minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

25.1 Nga ana tjetër, arritja e një niveli të besueshëm apo, sipas rastit, minimal kualifikues, analizohet rast pas rasti, sipas pretendimeve dhe rrethanave konkrete. Kolegji vlerëson se kalimi i barrës së provës nga Komisioni, për dyshimet për shkelje, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është i lidhur me detyrimin e Komisionit për të vendosur brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm, sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

25.2 Për këto arsye, Kolegji sjell në vëmendje se është detyrë e subjekteve të rivlerësimit që brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme të provojnë të kundërtën e dyshimeve të Komisionit, sipas konkluzioneve paraprake.

- 26.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi ishte marrë pa u mbyllur hetimi administrativ, pasi provat e paraqitura prej tij dhe kërkesat për to do të vlerësoheshin pas procesit ose nuk do të vlerësoheshin fare, Kolegjit i rezulton se Komisioni i ka vlerësuar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, madje Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka provuar të

¹³ Shih f. 3132 të dosjes së Komisionit.

¹⁴ Neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në ankim pretendon për shkelje flagrante të procesit, tej çdo logjike juridike.

kundërtën për disa prej rezultateve paraprake të arritura nga Komisioni¹⁶, por se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën e konkluzioneve të tjera paraprake të arritura nga Komisioni¹⁷.

26.1 Për këto arsye, Kolegji vlerëson se paraqitja e provave dhe vlerësimi i tyre janë momente të ndryshme procedurale dhe se Komisioni ka të drejtë të vlerësojë paraprakisht nivelin e provueshmërisë së provave, por pa i mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016¹⁸.

27. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kërkesat për prova, të paraqitura me *e-mail* dhe shkresë në datën 16.04.2019, pasi kishte mbaruar procesi i rivlerësimit ndaj tij, Kolegji vlerëson se të drejtat e subjektit të rivlerësimit janë të parashikuara nga neni 62 i ligjit nr. 84/2016, i cili i njeh këtij të fundit të drejtën e ankimit. Nga ana tjetër, neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pas dhënies së vendimit e ka pajisur Komisionin me kompetencën për të verifikuar veçse kushtet formale të pranueshmërisë së ankimit dhe dërgimin e tij së bashku me dosjen për shqyrtim në Kolegji, sipas nenit 48, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

Për këto arsye, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, pasi për çdo kërkesë apo pretendim që subjekti i rivlerësimit mund të ketë pas dhënies së vendimit, kompetenca i përket Kolegjit.

28. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është lajthitje e rëndë logjike dhe juridike vlerësimi i Komisionit se ai shfaq mungesë të etikës profesionale në përfundim të kësaj seance¹⁹, Kolegji vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, është e vlerësueshme nga Komisioni gjatë procedurës së zhvilluar para tij dhe deri para përfundimit të saj, duke marrë në konsideratë kërkesat e këtij neni.

28.1 Kolegji vëren një paqartësi në vlerësimin e Komisionit mbi sjelljen e subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, në raport edhe me vendimmarrjen përfundimtare të tij. Kështu, rezulton se Komisioni fillimisht ka mbajtur qëndrimin se subjekti i rivlerësimi kishte qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, duke zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, duke çuar në Komision provat dhe shpjegimet përkatëse. Ndërsa në vijim Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit shfaq mungesë të etikës profesionale në përfundim të seancës dëgjimore, menjëherë pas dhënies së vendimit²⁰. Kolegji vëren se Komisioni vlerësimin e mësipërm nuk e ka marrë parasysh në marrjen e vendimit²¹.

29. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale se ligji i ri për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë nuk gjen zbatim, sepse ka hyrë në fuqi në datën 07.11.2016 dhe nuk ka fuqi prapavepruese, Kolegji vlerëson se sipas neneve 42, pika 1, fjalia e parë dhe 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, burimet dhe procedurat, për aq sa ato janë të zbatueshme, për

¹⁶ Shih pikat 1.3 dhe 1.4 të vendimit të Komisionit.

¹⁷ Shih pikat 3.1 dhe 8.2 të vendimit të Komisionit.

¹⁸ Shih nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

¹⁹ Menjëherë pas dhënies së vendimit të Komisionit.

²⁰ Shih f. 5 të vendimit të Komisionit.

²¹ Shih konkluzionet përfundimtare në f. 38 të vendimit të Komisionit.

vlerësimin e aftësive profesionale, bazohen dhe kryhen në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, si dhe me fuqinë prapavepruese të parashikuar në ligj.

30. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka aplikuar barrën e provës në mënyrë tendencioze, me sjellje tej çdo etike dhe në kundërshtim me ligjin, Kolegjit i rezulton që Komisioni t'ia ketë kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi kishte arritur në përfundime paraprake, dhe me qëllim që ai të mund të provonte të kundërtën e këtyre përfundimeve paraprake.

30.1 Kolegji vlerëson se kalimi, nga ana e Komisionit, i barrës së provës subjektit të rivlerësimit, nuk ka qenë tendencioz, por se ka pasur për qëllim të përcaktojë rrethanat e fakteve të çështjes që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit, brenda afateve të arsyeshme, në përputhje me ligjin.

30.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ai e ka ribërë pothuajse të gjithë dokumentacionin, dhe se ishte përpjekur të siguronte sa të mundej të dhëna, pasi në referim të kujtesës, ishte gati e pamundur që saktësitë të ishin optimale për të gjithë arsyet njerëzore të ligjshme, Kolegji vlerëson se subjektet e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duhet t'i vërtetojnë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, ose nuk mund të bëhet përsëri apo të merret në rrugë tjetër, dhe për këtë arsye as ky pretendim nuk qëndron. Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se dokumentacioni i është kërkuar me *apostille*, pa bazë ligjore dhe në afat të shkurtër, duke e vënë në pozita të pafavorshme, dhe se provat merren në nivele të barabarta, me standardin e atyre që janë marrë për ta akuzuar (rënduar pozitën), duhet të merren edhe ato që ai paraqet, Kolegji vlerëson se sipas nenit 49, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016, dokumentet shkresore merren sipas formave të parashikuara në ligj.

31. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në thelb procedimi disiplinor i gjyqtarëve dhe prokurorëve është i ngjashëm me një procedim penal, dhe se duhet mbajtur parasysh fakti se askush nuk mund të akuzohet dhe të dënohet/shkarkohet vetëm duke u bazuar në një dëshmitar të vetëm, pasi në të kundërt do të cenonte parimet e procesit të rregullt ligjor, ku kërkohet që asnjë provë të mos ketë vlerë të paracaktuar, por duhet të vlerësohet në unitet me provat e tjera, të cilat duhet të debatohen në respektim të parimit të kontradiktoritetit, Kolegji vlerëson se procesi i rivlerësimit është një proces i rregulluar me ligj të posaçëm, gjatë të cilit nuk zbatohen parimet e procedimit dhe gjykimit penal, dhe për këtë arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

31.1 Procesi i rivlerësimit, një proces ngushtësisht administrativ, mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe nënligjor, dhe përcakton rastet e dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra apo të konfirmimit në detyrë të subjekteve të rivlerësimit, sipas parashikimeve në ligj. Për shkak të natyrës administrative, procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e ligjit të posaçëm dhe dispozitat e ligjit nr. 49/2012 që rregullon veprimtarinë dhe parimet mbi të cilat bazohet procesi në gjykatat administrative²².

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

32. Lidhur me apartamentet²³ me sip. 130 m², në lagjen "{***}", Vlorë, të deklaruara në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimi ka parashtruar në Kolegji pretendime për mospërfshirjen nga

²² Vendimi nr. 3/2020(JR), datë 04.03.2020, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 29.4.

²³ Dy apartamente, secili me sip. 65 m², adoptuar në banesë të përbashkët.

Komisioni të të ardhurave nga shitja e orendive të apartamentit në lagjen “{***}”, Vlorë, si dhe të pjesës takuese në këtë apartament të motrës së tij, znj. M. H. (A.).

32.1 Përkatësisht, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka llogaritur në analizën financiare për periudhën 1998 - 2002, shumën prej 1.000.000 lekësh, të përbërë nga: a) 500.000 lekë, nga pjesa e çmimit të shitjes së apartamentit në lagjen “{***}”, Vlorë, sipas kontratës nr. {***} rep., datë 14.10.2000, që i përkiste motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. M. H. (A.); si dhe b) 500.000 lekë, nga shitja e orendive të këtij apartamenti, shumë për të cilën, subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur deklaratat noteriale të blerësve.

32.2 Në vijim të pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Kolegjit i rezulton se nga kontrata shitblerje pasurie apartament banimi nr. {***} rep., datë 14.10.2000, shitësit Xh. A., H. A., Edison Ademi dhe M. H. (A.) i kanë shitur blerësit I. N. apartamentin e banimit të ndodhur në Vlorë²⁴, për çmimin 2.000.000 lekë. Kolegji vëren se objekti i shitjes sipas kontratës nr. {***} rep., datë 14.10.2000, është shitja e pasurisë së paluajtshme në çmimin e caktuar, pa përfshirë edhe shitjen e orendive shtëpiake, çka do të thotë se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me përcaktimet kontraktore.

32.3 Kolegji vlerëson se objekti i kontratës, çmimi i shitjes së apartamentit, sikurse dhe pjesët takuese, dëshmojnë nga vetë kontrata nr. {***} rep., datë 14.10.2000, pa qenë e nevojshme paraqitja e deklaratës noteriale të mëvonshme. Kolegji, bazuar në nenin 690 të Kodit Civil, vlerëson se kontrata e shitblerjes së pasurisë apartament banimi nr. {***} rep., datë 14.10.2000, ka forcën e ligjit për palët, dhe për sa kohë ajo nuk është ndryshuar apo prishur, sipas ligjit, Kolegji vlerëson se znj. M. H. (A.) ka përfituar pjesën e saj prej 500.000 lekësh, si pasojë e bashkëpronësisë në apartamentin e shitur.

32.4 Për të vërtetuar se nga çmimi i shitjes së apartamentit sipas kontratës së mësipërme, motra e tij, znj. M. H. (A.), nuk kishte marrë pjesën e saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2019, nëpërmjet së cilës znj. M. H. (A.) dhe z. S. H. kanë deklaruar se nga shitja e këtij apartamenti nuk kanë marrë asnjë shumë parash, pasi ai ishte kontribut i prindërve. Gjithashtu, për këtë qëllim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2019, nëpërmjet së cilës z. Xh. A. dhe znj. H. A. kanë deklaruar se vajza e tyre, e cila ishte e martuar me z. S. H., nuk mori asnjë shumë parash nga shitja e këtij apartamenti. Për të provuar të ardhurat prej 500.000 lekësh nga shitja e orendive, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratat noteriale, përkatësisht: a) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2019, nëpërmjet së cilës z. Th. M. ka deklaruar se në vitin 2000, pasi familja e z. Xh. A. ka shitur apartamentin në lagjen “{***}”, Vlorë, ai kishte blerë disa orendi shtëpiake²⁵, në shumën 170.000 lekë; si dhe b) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2019, nëpërmjet së cilës z. B. M. ka deklaruar se në vitin 2000-2001, pasi familja e z. Xh. A. ka shitur banesën në lagjen “{***}”, kishin rënë dakord për të blerë disa orendi shtëpiake dhe vegla pune²⁶, në shumën 350.000 lekë.

²⁴ Lagja “{***}”, rr. “{***}”, Vlorë, pll. {***}, sh. {***}, k. {***}.

²⁵ Orenditë e dhomës së gjumit, të përbërë nga dollap gjumi, krevat me sustë, komo me raftë me varëse e pasqyrë, dy divane të mëdhenj me hapje për fjetje, tavolinë buke druri, tavolinë mesi me xham e melaminë.

²⁶ Kuzhinën me përbërje entjef, bufë druri, pajisje elektroshtëpiake si frigorifer, lavatriçe, ngrohës, sobë, televizor të llojit “Samsung”, vegla e sende pune si karrocë dore, vegla e sende pune, çanta me vegla pune, trapano, lopata, kazma.

32.5 Kolegji, referuar jurisprudencës²⁷ së tij, arsyeton se deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijojnë bindjen se është konceptuar në favor të deklaratave të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

32.6 Për këto arsye, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të vërtetojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën prej 1.000.000 lekësh, me burim të pretenduar përkatësisht prej 500.000 lekësh nga pjesa e bashkëpronësisë së znj. M. H., dhe 500.000 lekësh të tjera nga shitja e orendive shtëpiake. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të vërtetojë bindshëm burimin e ligjshëm të shumës prej 1.000.000 lekësh, Kolegjit, sikurse edhe Komisionit, i rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për blerjen e apartamentin me sip. 130 m², në rr. “{***}”, Vlorë.

32.7 Lidhur me burimin e krijimit të apartamentit me sip. 130 m², në lagjen “{***}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se e njëjta shumë nuk mund të deklarohet dy herë, duke shpjeguar se shumën prej 8400 USD, me burim kredinë e marrë nga {***} Bank për blerjen e apartamentit me sip. 130 m², në lagjen “{***}”, ia ka dërguar vëllait në Angli në vitin 2003, dhe se në vitin 2004, nga vëllai i është kthyer shuma prej 8000 GBP. Bazuar në këto argumente, subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit, se “[...] mosdeklarimi i të ardhurave nga vëllai në emigracion, për diferencën prej 8000 GBP, e bën deklarin periodik për vitin 2004 të pasaktë. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën periodike për këtë vit, të ardhurën në shumën prej 8000 GBP, si dhurim prej vëllait”.

32.8 Kolegji vlerëson se mosdeklarimi në vitin 2004 i dhurimit nga vëllai të shumës prej 8000 GBP, për efekt të procesit të rivlerësimit, merr një vlerë të posaçme, si baza e vetme e informacionit, mbi të cilin do të duhej filluar hetimi administrativ²⁸ nga Komisioni, dhe më pas shqyrtimi gjyqësor nga Kolegji, në funksion të shkaqeve të ankimit. Në vijim, Kolegji vëren se ndryshe nga shuma prej 8000 GBP, e cila nuk është deklaruar në vitin 2004, shuma prej 8400 USD, është krijuar në vit të ndryshëm (2003), ka burim të ndryshëm dhe destinacion të përcaktuar për blerjen e apartamenteve me sip. 130 m², në Vlorë.

32.9 Kolegji, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vitin 2003 i ka dërguar vëllait në Britaninë e Madhe, z. A.A., shumën prej 8400 USD²⁹, me burim nga kredia në {***} Bank, e vlerësoi në raport me pagesat e çmimit të apartamenteve me sip. 130 m², në lagjen “{***}”, Vlorë. Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë dokumentacioni për pagesat e kryera në total për blerjen e apartamenteve dhe se ai nuk kishte sqaruar e shpjeguar në mënyrë të plotë pagesat e kryera për çmimin e blerjes së tyre. Në dosjen e ardhur nga Komisioni, në lidhje me pagimin e kësteve të apartamenteve, disponohen dokumente vetëm për pjesën e 28.200 USD, nga totali i çmimit të paguar³⁰.

²⁷ Vendimi nr. 6/2018, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendimi nr 11/2019, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; vendimi nr. 34/2019, datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

²⁸ Shih vendimin nr. 10/2020 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paragrafi 10.

²⁹ Sipas sqarimeve të subjektit të rivlerësimit në Komision e pretendimeve në ankim, mandatat të tërheqjes së shumës 8.400 USD nga llogaria e kredisë (nr. 025015100000410, në emër të Edison Ademi në {***} Bank).

³⁰ Përkatësisht: a) 5.000 USD me firmosjen e kontratës së prenotimit, siç shprehet në të, dhe pagesat konfirmuar me mandate banke, prej 18.200 USD në 14.11.2003; dhe b) 5.000 USD në datën 02.03.2004.

32.10 Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit i ka paguar shitësit, shoqëria “{***}” Shpk, me administrator z. B. R., në vitin 2003, shumën prej 35.000 USD, kurse pjesa prej 10.000 USD rezultoi t’i jetë paguar shitësit në vitin 2004. Kolegji vëren një situatë të ndryshme nga konstatimet e Komisionit, për sa i përket mënyrës së pagesës të çmimit, në favor të shitësit. Kështu, duke u bazuar në kontratën e shitblerjes (apartament banimi) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.08.2012, neni me titull “Çmimi dhe mënyra e pagesës”, në kontratën e prenotimit për shitje për ndërtim apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2003, neni XII “Detyrimet e porositësit”, si dhe në shkresën e datës 12.12.2018 të shitësit, shoqërisë “{***}” Shpk, Kolegjit i rezultoi se pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit në favor të shitësit janë si në vijim: a) kësti i parë në shumën 5.000 USD – me nënshkrimin e kontratës së prenotimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2003; b) kësti i dytë dhe kësti i tretë përkatësisht në shumat 20.000 USD dhe 15.000 USD – sipas urdhër kalimit të {***} Bank, datë 14.11.2003, në shumën 18.200 USD dhe pjesa e mbetur nga kësti i dytë dhe kësti i tretë, pas këstit të parë dhe deri në datën 14.11.2003, pa qenë i mundur përcaktimi i datës konkrete, por shlyer dorazi, sikurse pranohet nga palët kontraktore, se pagesat janë kryer me kushtet e kontratës së prenotimit; dhe c) kësti i fundit prej 5.000 USD në datën 02.03.2004, sipas urdhër kalimit të {***} Bank.

32.11 Kolegjit i rezultoi se kredia nga {***} Bank, në shumën prej 30.000 USD, është përdorur nga subjekti i rivlerësimit për pagimin e këstit të dytë dhe të tretë të apartamenteve me sipërfaqe totale 130 m², në Vlorë, dhe për këtë arsye shpenzimi i transferuar në favor të vëllait, z. A.A., sipas subjektit të rivlerësimit, nuk mund të ketë pasur të njëjtin burim me atë që ka shërbyer për blerjen e këtyre apartamenteve.

32.12 Nëse në analizën financiare të vitit 2003 do të llogaritej shuma prej 8.400 USD, të cilën subjekti i rivlerësimit pretendon se ia ka dërguar vëllait, z. A.A., në këtë vit, dhe nuk e ka përdorur për blerjen e apartamenteve me sip. 130 m² në Vlorë, Kolegjit do t’i rezultonte një situatë e ndryshme financiare nga situata e konstatuar në Komision për vitin 2003. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, për vitin 2003, janë përlllogaritur të ardhurat në vlerën prej 4.239.548 lekësh, përkatësisht: a) në shumën prej 978.848 lekësh nga puna e subjektit të rivlerësimit, sipas vërtetimeve të pagave nga institucionet përkatëse; dhe b) nga kredia e lëvruar nga {***} Bank më 13.11.2003³¹ dhe sipas vërtetimit të {***} Bank, datë 16.03.2016, në shumën prej 30.000 USD, ose 3.260.700 lekësh³². Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë investuar në pasurinë “apartamente 130 m² (dy hyrje nga 65 m², adoptuar në banesë të përbashkët me prindërit)”, për të cilat në vitin 2003 është paguar pjesa prej 40.000 USD (ose ekuivalenti në lekë prej 4.643.923 lekësh), si totali i: a) 5.000 USD (ose ekuivalenti³³ i 618.450 lekëve), me lidhjen e kontratës së porosisë më 04.09.2003; b) këstit të dytë dhe të tretë, përkatësisht në shumat 20.000 USD dhe 15.000 USD, pra pjesa prej 35.000 USD (ose ekuivalenti³⁴ i 4.025.473 lekëve).

³¹ Në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi 4/1.

³² Ekuivalenti në lekë sipas analizës së Komisionit, me kursin mesatar të dhjetor 2003, 1 USD = 108,69 lekë, sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë.

³³ Ekuivalenti në lekë me kursin e publikuar të Bankës së Shqipërisë në datën 04.09.2003, të lidhjes së kontratës, 1 USD = 123,69 lekë.

³⁴ Ekuivalenti në lekë, për pjesën prej 18.200 USD, me kursin mesatar të muajit dhjetor 2003, me të njëjtin kurs të konvertimit në lekë të kredisë dhe pjesës tjetër prej 16.800 USD për të cilën nuk provohet data ekezakthe e pagesës shitësit, me kursin mesatar vjetor (1 USD = 121,86 lekë) të publikuar të Bankës së Shqipërisë.

32.13 Nga analiza e kryer në Kolegj, totali i të ardhurave prej 4.239.548 lekësh nuk do të ishte i mjaftueshëm as edhe vetëm për blerjen e apartamenteve me sip. 130 m², në vlerën 4.643.923 lekë, pa llogaritur këtu shpenzimet e nevojshme për jetesë. Nga sa më sipër, Kolegji, pasi mori në shqyrtim pretendimin në ankim të subjektit të rivlerësimit se ka dërguar shumën prej 8400 USD në Angli, në favor të vëllait, z. A.A., konstaton se diferenca negative e konstatuar për mbulimin e çmimit të blerjes së apartamenteve me të ardhura të ligjshme, do të thellohej dhe më tej.

32.14 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, si burim për blerjen e pasurisë apartamente me sip. 130 m², ka deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit në Vlorë dhe kredinë në {***} Bank. Përkundër këtij pretendimi, Kolegjit i rezulton se kontrata e porosisë është lidhur në datën 04.09.2003 dhe pagesa e këstit të parë prej 5000 USD është kryer në këtë datë, dhe nga ana tjetër kredia prej 30.000 USD në {***} Bank është lëvruar më vonë, në datën 13.11.2003³⁵, çka përjashton mundësinë që kësti i parë të ketë pasur si burim kredinë nga {***} Bank. Gjithashtu, Kolegjit nuk i rezulton që burimi i këstit të parë të ketë qenë shitja e apartamentit në Vlorë, në vitin 2000³⁶, pasi kjo vlerë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur në deklaratën periodike 2004. Kolegji, duke i vlerësuar në tërësi rrethanat, vëren se nga dokumenti “Pjesë nga procesverbali për kontrollin e përgjithshëm të pasurisë, kryer nga ILDKPKI në vitin 2016”, referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 24.10.2020, i pyetur nga ILDKPKI se cili ka qenë burimi i shumës së paguar për blerjen e apartamenteve me sip. 130 m², përveç kredisë në {***} Bank, ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën *vetting*³⁷, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] nga të ardhurat tona familjare nga paga dhe ndihma që dërgonte vëllai nga Anglia”.

32.15 Për këto arsye, Kolegji në përfundim të analizës së mësipërme, në funksion të shkaqeve të ankimit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* në mënyrë të pasaktë burimin e krijimit të apartamenteve me sip. 130 m² në Vlorë.

- 33.** Lidhur me sendet dhe mobiliet në vlerën 800.000 lekë, të deklaruara në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se ka një pasaktësi për mosdeklarimin e burimit të krijimit, me arsyetimin se ai ka dorëzuar kontratën e kredisë me R. Bank, me vlerë 700.000 lekë, duke theksuar se ai është proces dhe jo thjesht analizë deklarate.

33.1 Kolegji çmon se, në mungesë të deklarimit të burimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, sikurse në rastin konkret burimi i krijimit të këtyre sendeve dhe mobilieve, identifikimi i burimit dhe më tej vërtetimi i saktësisë së tij mbetet objekt i hetimit administrativ³⁸ të Komisionit dhe, në funksion të shkaqeve të ankimit, objekt kontrolli gjyqësor nga Kolegji.

33.2 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting* kontratën nga {***} Bank në shumën 700.000 lekë³⁹, por në deklaratën *vetting* ka përshkruar pasuritë për pjesën e sendeve dhe mobilieve të banesës në vlerën 800.000 lekë, dhe nuk e ka plotësuar

³⁵ Sipas vërtetimit të {***} Bank, datë 16.03.2016, në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi {***}.

³⁶ Pas anulimit të kontratës verbale me “{***}” ShPK për shumën prej 2.500.000 lekësh.

³⁷ “Burimi: 1. Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., datë 14.10.2000, shitja e banesës së prindërve nr. {***}, lagjja “{***}”, Vlorë, vlera 2.500.000 lekë, me gjithë sendet në të. 2. Kontratë kredie nr. {***}, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2003, me {***} Bank, prej 30.000 USD (12 vjet).”

³⁸ Shih vendimin nr. 10/2020(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 10.

³⁹ Shih dosjen e ILDKPKI-së, aneksi {***}.

deklaratën *vetting* me të dhënat e burimit të krijimit të këtyre pasurive, çka e bën të paplotë deklarinimin e subjektit të rivlerësimit.

33.3 Për sa i përket vlerës së kredisë për mobilim, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është pasqyruar as si e ardhur në analizën financiare. Kolegji vëren se ky pretendim nuk qëndron pasi Komisioni e ka konsideruar kredinë si të ardhur në shumën 700.000 lekë, në seksionin “Detyrime”, në analizën e vitit 2005 me vlerë pozitive, pra si e ardhur me përshkrimin “Kredi {***} Bank, për mobilim, 700.000 lekë”, si dhe në seksionin “Shpenzime” me përshkrimin “Shpenzim mobilimi sipas kredisë 700.000 lekë dhe pyetësorët”. Gjithashtu Kolegji konstaton se Komisioni duhet të kishte konsideruar si të ardhur vetëm shumën 686.000 lekë, dhe jo vlerën e plotë të kredisë prej 700.000 lekësh, sepse nga vlera totale e kredisë duhet të ishte zbritur edhe komisioni bankar në shumën prej 14.000 lekësh⁴⁰, e cila do të ndikonte në rezultatin e vitit duke e thelluar diferencën negative të vitit 2005.

33.4 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka bërë një shpërndarje subjektive të vlerave të arredimit, pa iu referuar në mënyrë korrekte shpjegimeve të tij, Kolegji vëren se vlerat në lidhje me shpenzimet e mobilimit Komisioni i ka shpërndarë, përkatësisht: a) vlerën 700.000 lekë në vitin 2005; dhe b) vlerën 100.000 lekë në vitin 2004, duke iu referuar shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 16.02.2019, pyetja 2⁴¹, sipas të cilave: “arredimi bazë është ai i dy viteve të para (2004, 2005)”. Gjithashtu, në analizën financiare në ankim, f. 72, subjekti i rivlerësimit ka bërë të njëjtën shpërndarje të shpenzimeve për mobilim sikurse dhe Komisioni, përkatësisht 100.000 lekë në vitin 2004 dhe 700.000 lekë në vitin 2005. Edhe në analizën financiare në ankim, f. 72, në përgjigjet e rezultateve hetimore⁴² dhe në raportin e rivlerësimit kontabël, datë 23.03.2019, përgatitur nga eksperti kontabël⁴³ B. H, bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka bërë të njëjtën shpërndarje ndër vite⁴⁴, si dhe e ka paraqitur si të ardhur njësoj kredinë⁴⁵, ashtu sikurse dhe Komisioni.

33.5 Për këto arsye, Kolegji, sikurse dhe Komisioni, vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të paplotë për pjesën e mosdeklarimit të burimit të krijimit të sendeve dhe mobilieve, me vlerë 800.000 lekë.

⁴⁰ Bashkëlidhur - Shkresa kthim përgjigjeje nr. {***} prot., 10.04.2018, nga {***} Bank, në dosjen e Komisionit, ku vihet re se në datën 16.12.2005, e lëvrimit të kredisë, është mbajtur dhe komision në shumën 14.000 lekë, me përshkrimin “{***}”.

⁴¹ Referuar vendimit të Komisionit, në faqen 15, në paragrafin e tretë dhe të katërt: “Në përgjigjet e pyetësorit të parë, subjekti ka konfirmuar vlerën e përafërt të mobilimeve prej 800.000 lekësh, duke sqaruar se nuk ka bërë rinovime, pasi prej katër vitesh është më shumë i larguar nga kjo banesë dhe se nuk disponon fatura për të vërtetuar shpenzime mobilimi. Subjektit i është kërkuar gjithashtu të saktësojë periudhën se kur është bërë arredimi. Në shpjegimet e tij, ai ka sqaruar se: “[...] arredimi bazë tij u përket dy viteve të para, 2004 – 2005 [...]”. Duke qenë se subjekti nuk ka specifikuar shumat përkatëse në secilin vit, dhe kredia është marrë në vitin 2005, shpenzimet për arredim në shumën prej 700.000 lekësh i janë llogaritur për këtë vit, duke konsideruar se këto shpenzime janë bërë pikërisht me kredinë prej 700.000 lekësh, të marra nga {***} Bank, ndërsa shpenzimet në shumën prej 100.000 lekësh i janë llogaritur gjatë vitit 2004, vit në të cilin subjekti nuk ka rezultuar me diferenca të pajustificuara.

⁴² Faqe 49, për të gjithë periudhën 2003-2016.

⁴³ Eksperti kontabël B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij në tabelën financiare për të gjithë periudhën 2003-2016.

⁴⁴ Specifikisht në vitin 2004 shumën 100.000 lekë dhe në vitin 2005 shumën 700.000 lekë.

⁴⁵ Në vitin 2005 te seksioni detyrime me vlerë pozitive, pra si hyrje/e ardhur.

34. Lidhur me automjetin Mercedes Benz E270, me targë {***}, të këmbyer me automjetin me targë {***}, i cili rezulton të jetë deklaruar në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk duhej të përfshihej si shpenzim në vitin 2012 vlera prej 800.000 lekësh, sepse automjeti Mercedes Benz E270, me targë {***}, nuk ishte blerje, por dhuratë nga vëllai, z. A.A.

34.1 Kolegji vëren se në deklaratën vjetore 2012, e cila mund të përdoret si provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit këtë pasuri e ka deklaruar si autoveturë, me blerje. Gjithashtu, Kolegjit, nga praktika e regjistrimit të këtij automjeti⁴⁶, i rezulton e depozituar edhe fatura e shitjes, datë 20.07.2012⁴⁷, për këtë automjet. Kolegji vëren se edhe vetë subjekti i rivlerësimit në raportin e vlerësimit kontabël, datë 23.03.2019, të përgatitur nga eksperti kontabël⁴⁸ B. H, bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, ka përfshirë shpenzim, në seksionin pasuri, shumën 800.000 lekë, me të njëjtin përshkrim: “Autoveturë E270 {***} Daimler Crysler” në analizën e vitit 2012.

34.2 Për të mbështetur pretendimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2019, nëpërmjet së cilës vëllai i tij, z. A.A., deklaroi se ky automjet ishte dhuratë dhe nuk kishte pranuar të merrte nga subjekti i rivlerësimit vlerën e tij, pavarësisht këmbënguljes së këtij të fundit.

34.3 Kolegji, sikurse dhe më sipër, referuar jurisprudencës⁴⁹ së tij, arsyeton se deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit, që në këtë rast kjo deklaratë noteriale bie ndesh me deklaratën periodike 2012, të deklaruar në ILDKPKI, dhe faturën e shitjes datë 20.07.2012, pjesë e praktikës së regjistrimit të automjetit në DPSHTRr.

34.4 Kolegjit, bazuar në rrethanat faktike të pasqyruara në këto dokumente, i rezultoi se z. A.A. i ka shitur subjektin të rivlerësimit automjetin tip Daimler Crysler, në shumën 4.000 GBP, të regjistruar me targë {***}, dhe që sipas deklarimit periodik 2012, vlera e blerjes/zhdoganimit/targimit, në total rezultonte 800.000 lekë.

34.5 Për këto arsye, Kolegji, sikurse dhe Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2012, ka kryer shpenzimin prej 800.000 lekësh për blerjen e këtij automjeti, për pasojë shkak i ankimit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këto fakte mbetën të pabazuar.

34.6 Kolegji vlerëson se diferenca negative prej (-) 886863 lekësh, sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2012, do të reduktohej nëse do të përfshiheshin në analizë të

⁴⁶ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 25.04.2018, të DPSHTRr-së.

⁴⁷ Shprehimisht, në faturën e shitjes, në gjuhën angleze, të nënshkruar nga z. A.A., të panëshkruar nga subjekti i rivlerësimit, dëshmohet se: “I A.A., have sold the car type Mercedes Benz E270CDI, registration {***} to my brother Edison Ademi for the sum of £ 4.000. The car is sold as seen with no warranty given.” - “Unë i nënshkruari A.A., i kam shitur automjetin tip Mercedes Benz E270CDI, të regjistruar me nr. {***}, vëllait tim Edison Ademi, në shumën prej £ 4.000. Automjeti është shitur sipas gjendjes në dukje, pa u dhënë garanci.”

⁴⁸ Eksperti kontabël B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij, në tabelën financiare për të gjithë periudhën 2003-2016.

⁴⁹ Vendimi nr. 6/2018, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendimi nr. 11/2019, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; vendimi nr. 34/2019, datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

ardhurat nga interesat e depozitave në shumën 39722⁵⁰ lekë për vitin 2012. Përfshirja e interesave të depozitave e përmirëson situatën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke e reduktuar diferencën negative, por sërish subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar plotësisht shpenzimet e kryera dhe pasurinë.

35. Lidhur me gjendjen *cash* prej 10000 eurosh, të deklaruar në deklaratën *vetting*, me burim krijimi kursime, kontribute nga emigracioni dhe pjesë nga kreditë, subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se ai në vitet e krijimit të kësaj gjendjeje *cash* kishte rezultuar me diferenca të pajustificuara me të ardhura të ligjshme, duke pretenduar që justifikohet plotësisht nga të gjitha të ardhurat e ligjshme, dhe se balancat pozitive në fund të çdo viti duhet t'i shtohen gjendjes së likuiditeteve në *cash* në vitin pasardhës.

35.1 Në vijim të pretendimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit, se balancat pozitive në fund të çdo viti duhet t'i shtohen gjendjes së likuiditeteve në *cash* në vitin pasardhës, Kolegjit nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit t'i ketë deklaruar këto likuiditete *cash* në deklaratat periodike si pasuri të shtuara në formën e likuiditeteve në *cash*, përveç se në dy vite, përkatësisht: a) në deklaratën periodike 2014, në shumën prej 5000 GBP, me burim krijimi, tërheqje nga depozita e deklaruar në {***}⁵¹ Bank, kursime familjare të shtuara; dhe b) në deklaratën periodike 2016, në shumën prej 3500 eurosh, me burim krijimi shtesë në gjendjen e mëparshme, kursime, mbetje nga kredia 2016.

35.2 Kolegji konstaton se në analizën financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, f. 72, në përgjigjet të rezultateve hetimore⁵² dhe në raportin e vlerësimit kontabël, datë 23.03.2019, të përgatitur nga eksperti kontabël B.H⁵³, bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, në vitin 2016 balanca pozitive e pretenduar për këtë vit, apo likuiditetet *cash* të pretenduara për këtë vit, rezulton të jetë (+) 4945289 lekë. Kjo shumë është disa herë më e madhe nga sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, përkatësisht shumën prej 10000 eurosh. Kolegji konstaton se shkak i ankimit dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me deklarinimin në deklaratën *vetting*.

35.3 Në vijim të pretendimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit në lidhje me likuiditetet *cash* të deklaruara në deklaratën *vetting*, se justifikohet plotësisht nga të gjitha të ardhurat e ligjshme, në analizë të viteve të krijimit të likuiditetit në *cash*, lidhur me gjendjen *cash* në vitin 2014, në shumën prej 5000 GBP, me burim tërheqje nga depozita e deklaruar në {***} Bank dhe kursimet familjare të shtuara, Kolegji konstatoi sa më poshtë.

- a) Për sa i përket tërheqjes nga depozita në {***} Bank, e cila rezulton të ketë ndodhur në datën 10.04.2014, për shumën prej 3040 USD⁵⁴ ose 1845 GBP⁵⁵, u analizua mundësia e krijimit të

⁵⁰ Si total i interesave të përfutur: në {***} Bank nga djali i subjektit të rivlerësimit, E. A., në llogarinë në lekë; nga depozita në {***} Bank e babait të subjektit të rivlerësimit; nga llogaria në {***} Bank dhe depozita në {***} Bank e subjektit të rivlerësimit.

⁵¹ <https://www.nbg.gr/en> – {***} ({***}).

⁵² Faqe 49, për të gjithë periudhën 2003 - 2016.

⁵³ Eksperti kontabël B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij në tabelën financiare për të gjithë periudhën 2003-2016.

⁵⁴ Sipas lëvizjeve të llogarisë në {***} Bank të depozitës nr. {***} sjellë nga Banka bashkëlidhur shkresës dërguar Komisionit, {***}, datë 05.04.2018 dhe me të Komisionit nr. {***} prot, datë 10.04.2018.

⁵⁵ Sipas kursit mesatar të vitit 2014 prej GBP=1.6474 USD (<https://www.exchangerates.org.uk/GBP-USD-spot-exchange-rates-history-2014.html>).

depozitës sipas lëvizjes së llogarisë së depozitës në {***} Bank, si dhe u analizua mundësia e krijimit në vitet e shtimit të depozitës në 14.12.2009, në shumën 5050 USD.

Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, përfshirë informacionin që gjendet në dosjen e ardhur nga Komisioni, për vitin 2009, janë përlllogaritur të ardhurat në vlerën prej 1.503.769 lekësh nga puna e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të pagave të sjella nga institucionet përkatëse dhe nga të ardhurat nga pensioni i babait të subjektit të rivlerësimit.

Në këtë analizë është përfshirë ndryshimi, shtimi i likuiditeteve në bankë, për një total prej 595.284 lekësh (diferencë e gjendjeve të likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2009 me ato në fund të vitit 2008).

Gjatë vitit, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë kryer shpenzime për pagesat e kredisë në {***} Bank (principal + interesa), marrë në vitin 2003 (shuma prej 30.000 USD), në shumën prej 311.750 lekësh⁵⁶, për pagesat e kredisë në {***} Bank (principal + interesa), marrë në vitin 2005 (shuma prej 700.000 lekësh për mobilim), në shumën prej 237.452 lekësh, si dhe shpenzime jetese për familjen e subjektit të përbërë nga pesë anëtarë, për një total prej 803.571 lekësh.

Nga kjo analizë, rezulton se totali i të ardhurave prej 1.503.769 lekësh nuk do të ishte i mjaftueshëm për përbalimin e shpenzimeve të kryera gjatë vitit dhe shtimin e likuiditeteve në bankë, ku përfshihet dhe shtesa e depozitës së mësipërme në {***} Bank, në total në vlerën 1.948.057 lekë⁵⁷, pas së cilës rezulton me diferencë negative (-) 444.288 lekë.

Duke konsideruar edhe të ardhurat nga interesat e depozitave në vitin 2009, sipas shkakut të ankimit të subjektit trajtuar në vijim, për një total prej 6.701 lekësh, diferenca negative do të reduktohej, por sërish subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me diferencë negative dhe pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera dhe shtimin e likuiditeteve të shtuara në bankë - depozitës në {***}, që ka shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve *cash* në vitin 2014.

- b) Për sa u përket kursimeve familjare të shtuara, prej 5000 GBP, pjesa prej 3155 GBP (diferencë e 5000 GBP - 1845 GBP tërheqje nga depozita analizuar më lart), nga analiza financiare e kryer në Kolegj, përfshirë informacionin që gjendet në dosjen e ardhur nga Komisioni, për vitin 2014, janë përlllogaritur të ardhurat në vlerën prej 2.260.064 lekësh nga puna e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të pagave të sjella nga institucionet përkatëse dhe nga të ardhurat nga pensionet e babait dhe të nënës së subjektit të rivlerësimit.

Në këtë analizë është përfshirë ndryshimi, pakësimi i likuiditeteve në bankë për një total prej (-) 152.938 lekësh (diferencë e gjendjeve të likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2014 me ato në fund të vitit 2013), si dhe shtimi i likuiditeteve të deklaruara në *cash*, në shumën 5000 GBP (ose 897.400 lekë).

Gjatë vitit ka kryer shpenzime për pagesat e kredisë në {***} Bank (principal + interesa), marrë në vitin 2003 (shuma prej 30.000 USD), në shumën prej 303.826 lekësh, për pagesat e kredive në {***} Bank (principal + interesa), marrë në vitin 2011 (shuma prej 870.000 lekësh) në shumën prej 245.198 lekësh, përfshirë edhe shpenzime udhëtimi në shumën prej 168.132 lekësh, shpenzime shkollimi në shumën prej 72.000 lekësh, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësor, shpenzime qiraje për tokën bujqësore në {***} (0,5 ha)

⁵⁶ Ose në vlerën prej 3.317 USD sipas lëvizjeve të llogarisë së subjektit të rivlerësimit në {***} Bank.

⁵⁷ Përkatësisht: 595.284 lekë + 311.750 lekë + 237.452 lekë + 803.571 lekë.

në shumën prej 5000 lekësh, shpenzime kartë krediti në shumën prej 191,6 eurosh (ose 26901 lekësh), si dhe shpenzime jetese për familjen e subjektit të rivlerësimit të përbërë nga 6 anëtarë, për një total prej 964286 lekësh.

Nga kjo analizë, totali i të ardhurave prej 2260064 lekësh nuk do të ishte i mjaftueshëm për përbalimin e shpenzimeve të kryera gjatë vitit dhe shtimin e likuiditeteve në formë *cash*, si dhe pakësimin e likuiditeteve në bankë, për një total të detajuar si më sipër, në vlerën 2529805 lekë (- 152938 lekë + 897400 lekë + 303826 lekë + 245198 lekë + 168132 lekë + 72000 lekë + 5000 lekë + 26901 lekë), e rezulton me diferencë negative (-) 269741 lekë.

Duke konsideruar dhe të ardhurat nga interesat e depozitave në vitin 2014, sipas shkakut të ankimit të subjektit trajtuar në vijim, për një total prej 25149 lekësh, diferenca negative do të ulej, por sërish do të rezultonte me diferencë negative e pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera dhe shtimin e likuiditeteve të shtuara në *cash* në këtë vit.

35.4 Pra, për vitet e krijimit të gjendjes së deklaruar *cash*, prej 10.000 eurosh, në deklaratën *vetting*, në analizë të viteve të krijimit⁵⁸ sipas burimeve të deklaruara të krijimit në deklaratën vjetore të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka qenë me një total diferencë negative në mbulimin me të ardhura të ligjshme prej (-) 714.029 lekësh⁵⁹ në vitet e krijimit të burimit të likuiditetit në *cash*, por duke konsideruar të ardhurat nga interesat e depozitave në vitet përkatëse, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, diferenca negative do të reduktohej, por sërish do të rezultonte negative.

35.5 Për këto arsye, Kolegjit, sikurse dhe Komisionit, për pasurinë në likuiditete, gjendjen *cash* prej 10.000 eurosh, të deklaruar në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit në përfundim të analizës si më sipër i rezulton me diferencë të pajustificuar në vitet e krijimit të kësaj pasurie.

- 36.** Lidhur me të ardhurat e vëllait, z. A.A., të cilat nuk janë deklaruar në deklaratën *vetting*, në pjesën e personit të lidhur, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit, i cili ka llogaritur si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat e deklaruara në deklaratën vjetore 2016, në shumën prej 6000 GBP, por që nuk ka llogaritur të ardhurat e pretenduara për vitet e tjera.

36.1 Kolegji çmon se në mungesë të deklarimit të pasurive dhe të burimit të krijimit të tyre në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *vetting*, sikurse në rastin konkret, pasuritë e personit të lidhur, z. A.A., identifikimi i burimit dhe më tej vërtetimi i saktësisë së tij mbetet objekt i hetimit administrativ⁶⁰ të Komisionit dhe, në funksion të shkaqeve të ankimit, objekt kontrolli gjyqësor nga Kolegji.

36.2 Kolegji konstaton se në rezultatet e hetimit paraprak, lidhur me të ardhurat e personit të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A.A., Komisioni është shprehur: “Sa më sipër, konstatohet se në deklarinimin për *vetting*: vëllai i subjektit, zoti A.A., ka bërë deklarinim të rremë dhe fshehje pasurie; subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarinim të ardhurash të vëllait të tij si person i lidhur, dhe ka fshehje pasurie, pasi nuk ka deklaruar autoveturën Mercedes Benz në emër vëllait A.A.; sipas nenit 33, pika 5, germat c dhe ç të ligjit nr. 84/2016 [...] 1. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga vëllai A.A., gjatë hetimit paraprak, u konstatua se: për vitet

⁵⁸ Pra, asaj të deklaruar në vitin 2014.

⁵⁹ Si total i diferencës negative të krijimit të shtesës së depozitës në vitin 2009 prej (-) 444.288 lekësh dhe diferencës negative për krijimin e kursimeve familjare të shtuara në vitin 2014 prej (-) 269.741 lekësh.

⁶⁰ Shih vendimin nr. 10/2020 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 10.

2003, 2014, 2015, 2016, 2017, 2008, 2009, 2010, 2012, 2011, 2013, 2014 dhe 2015 nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të zotit A.A., për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore sipas parashikimit të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016; për vitin 2016, vërtetohen të ardhura të ligjshme të zotit A.A., për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore sipas kësaj dispozite; nga informacionet bankare për zotin A.A., të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se vlerat e pasqyruara janë minimale, dhe nuk pasqyrojnë të ardhurat nga pagat, si rrjedhim nuk janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare”.

36.3 Me përgjigjet e rezultateve hetimore paraprake⁶¹ për të ardhurat e personit të lidhur, vëllait A.A., subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumentet e dorëzuara dhe më parë në Komision, por me *apostille*⁶² (pasi një pjesë e tyre ishin dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pa *apostille* në ILDKPKI⁶³ dhe në përgjigje të pyetësorëve⁶⁴), si më poshtë.

- a. Pasaportë me nr. {***}, lëshuar në Mbretërinë e Bashkuar (UK).
- b. *Statement* bankar i Bankës {***}, datë 16.09.2018.
- c. Letër vërtetimi nga shoqëria “{***}”, datë 07.02.2019.
- ç. Certifikata e fundvitit {***} 2015 dhe 2018.
- d. *Statement* aktual bankar nga {***} Bank, 02.12.18, 02.11.18, 02.10.18, 02.09.18 dhe 07.02.19.
- dh. Certifikatë për armëmbajtje nr. {***}/2017 – A.A.
- e. Letër vërtetimi nga shërbimet {***}, datë 12.02.19, e shoqëruar me mandatpagesa 08.04.2016 - 06.04.2018, në emër të z. A.A.⁶⁵.

36.4 Në vendim, Komisioni ka konstatuar dhe vlerësuar se: “[...] subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë të ardhura ligjore të shtetasit A.A. në Mbretërinë e Bashkuar përgjatë viteve 2004 deri në vitin 2015, për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore ose sigurimet shoqërore. Për këto arsye, të ardhurat e pretenduara si dhuratë nga vëllai për këto vite, në shumën prej 25.000 GBP dhe 550.000 lekësh, nuk janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare për periudhën e vlerësimit 2003 - 2015. Ndërkohë, të ardhurat e deklaruara për vitin 2016, janë marrë në konsideratë, sipas deklaramentit periodik për këtë vit, në shumën prej 6000 GBP, për shkak se subjekti vërtetoi me dokumentacion të rregullt ligjor, legalizuar me vulën *apostille* burimin nga të ardhura të ligjshme të vëllait të tij”. E më tej Komisioni ka konkluduar se: “Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës; pika 4 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 21 e udhëzimit të ILDKPKI-së nr. {***}, datë 10.10.2016, kërkojnë që për të ardhurat e deklaruara, subjektet e rivlerësimit, personat e lidhur, ose persona të tjerë të lidhur me ta, kur këta të fundit janë në kushtet e pikës 4, nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to. Ky

⁶¹ Nr. {***} prot., datë 01.04.2019, e Komisionit.

⁶² Referuar dhe në raportin e përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit paraprak, nr. {***} prot., datë 01.04.2019, të Komisionit, në faqen 37 të tij: “Nga ana jonë janë marrë në Angli me vulë *apostille* të gjitha dokumentet që provojnë korrektesën tonë, me shumë përpjekje, shpenzime e vështirësi për shkak të një sistemi të ndryshëm nga ne, ku të drejtat dhe liritë janë parësore”.

⁶³ Në Aneksin {***} në dosjen e ILDKPKI-së, pa vulë *apostille* dhe në gjuhën angleze.

⁶⁴ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 dhe atij shtesë, dërguar nga subjekti i rivlerësimit në datë 10.02.2019, me nr. {***} prot., dt. 13.02.2019 të Komisionit. dhe nga subjekti i rivlerësimit në dt. 16.02.2019, me nr. {***} prot., dt. 20.02.2019, të Komisionit, pa vulë *apostille* dhe të përkthyer në shqip me vërtetim përkthimi dt. 09.02.2019, nr. {***} rep. [vërtetimi i “{***}”, datë 27.10.2016 dhe payslip nga {***} LTD të vitit 2018 dhe 01.07.2016 - 30.12.2016].

⁶⁵ Dokumentet mbajnë vulë *apostille*, datë 01.03.2019, nga noteri Ch. D. G.

detyrim ligjor nuk është përmbushur nga subjekti, për sa u takon të ardhurave të pretenduara, të përfituara nga vëllai gjatë viteve 2004 - 2015 dhe, si rrjedhim, shumë prej 25.000 GBP dhe 550.000 lekësh, nuk janë marrë në konsideratë si e ardhur ligjore gjatë analizës financiare”.

36.5 Komisioni, nga sa më sipër, ka konsideruar si të ardhura të ligjshme vetëm shumën e deklaruar në vitin 2016, prej 6.000 GBP, për të cilat subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur dokumente në formën e kërkuar nga ligji, ndërsa për vitet 2004 - 2015, për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk kishte paraqitur dokumente në formën e kërkuar nga ligji, Komisioni nuk ka konsideruar në analizë të ardhurat nga vëllai, z. A.A.

36.6 Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, për sa u përket të ardhurave të z. A.A., ka paraqitur dokumentacionin e renditur sipas viteve, si më poshtë.

36.7 Për periudhën dhjetor 2002 - shtator 2011:

- a) Vërtetim punësimi, datë 27.10.2016⁶⁶, i shoqërisë “{***}”, me të cilin konfirmohen raportet e punës së vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A.A., pranë kësaj shoqërie. Sipas vërtetimit të punësimit më sipër, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës (pra, në shtator të vitit 2011), z. A.A. ka përfituar një të ardhur vjetore prej 19.396 GBP. Nuk ka dokumente të tjera për këtë periudhë, ndërkohë që Komisioni për këtë periudhë ka vlerësuar⁶⁷ se: “[...] nuk është vërtetuar pagimi i detyrimeve tatimore”. Kolegji vëren se në vërtetimin e datës 27.10.2016, të punëdhënësit “{***}”, nuk rezultojnë të dhëna mbi vlerat e detyrimeve tatimore që duhet të ishin apo janë paguar ose mënyrën e kryerjes së pagesës së vetë pagës apo detyrimeve tatimore mbi pagën, dhe për këtë arsye nuk është i mjaftueshëm me qëllim për të vërtetuar të ardhurat mbi pagën dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura. Për këto arsye, Kolegji gjen të bazuar në ligj⁶⁸ vlerësimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A.A., për vitin 2011.
- b) Vërtetimi i datës 07.02.2019⁶⁹, i shoqërisë “{***}”, me të cilin konfirmohen raportet e punës së vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A.A., pranë kësaj shoqërie, se subjekti ishte paguar çdo muaj dhe të gjitha taksat dhe sigurimet kombëtare ishin mbajtur nga paga e tij në mënyrën e duhur. Kolegji vëren se në vërtetimin e datës 07.02.2019, të punëdhënësit “{***}”, nuk rezultojnë të dhëna mbi pagën dhe vlerat e detyrimeve tatimore që duhet të ishin paguar mbi pagë, apo mënyrën e kryerjes së pagesës së vetë pagës apo detyrimeve tatimore mbi pagën, dhe për këtë arsye nuk është i mjaftueshëm me qëllim për të vërtetuar të ardhurat nga paga dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore.

⁶⁶ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 dhe atij shtesë, dërguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 10.02.2019 me nr. {***} prot., dt.13.02.2019, të Komisionit dhe nga subjekti i rivlerësimit në dt. 16.02.2019, me nr. {***} prot., dt. 20.02.2019 të Komisionit, pa vulë apostille dhe të përkthyer në shqip me vërtetim përkthimi, dt. 09.02.2019, nr. {***} rep. [vërtetimi i “{***}”, datë 27.10.2016].

⁶⁷ Në vendim, faqe 27, paragrafi 6, pika ii.

⁶⁸ Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

⁶⁹ Bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore paraprake, nga subjekti i rivlerësimit, nr. {***} prot., datë 01.04.2019, të Komisionit, me vulë apostille datë 01.03.2019, nga noteri Ch. D. G., në gjuhën angleze.

Për këto arsye, Kolegji gjen të bazuar vlerësimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të ardhura nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A.A., për vitin 2011.

36.8 Për periudhën shtator 2011 - 2015, nuk ka vërtetime pune apo dokumentacion, pasi siç shprehet subjekti i rivlerësimit në pyetësor⁷⁰, një prej kompanive ku ka punuar z. A.A., ka falimentuar dhe nuk kishte pasur mundësi të merrte dokumentacion.

a) Për sa i përket vitit 2015, për periudhën 24.09.2015 - 31.12.2015, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një nxjerrje të llogarisë bankare (*statement*) të {***}⁷¹, në të cilin vërehen kreditime në llogari në shumën 9.287 GBP (shuma 4.374 GBP të kredituar nga "{***}"), të tjerat nuk kanë përshkrime specifike).

Kolegji çmon se, për sa kohë që nuk rezultojnë përshkrime specifike për qëllimin e pagesave, nuk është e mundur që të përcaktohet lloji i të ardhurës, as ligjshmëria e saj dhe, si pasojë, kjo nxjerrje e llogarisë bankare nuk është e mjaftueshme me qëllim për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme apo shlyerjen e detyrimeve tatimore.

b) Në përgjigje të rezultateve hetimore⁷², Kolegji vëren se është bashkëlidhur një dokument në gjuhën angleze "{***}", me punëdhënësin "{***}" për A. Ademi, me shumë 7.587,45 paund dhe zbritje takse 1.092,8 paund.

Kolegji vëren se sipas kësaj certifikate, rezultojnë shumat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e punësimit pranë {***}, por jo shumat e të ardhurave në vetvete.

Për këto arsye, Kolegji gjen të bazuar vlerësimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të ardhura nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A.A., për vitin 2015.

36.9 Për vitin 2016:

a) Për sa i përket periudhës 22.02.2016 - 16.04.2016, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur *statement* bankar, datë 16.04.2016, nga {***}, ku përfshihen veprimet kryesore në këtë bankë, me debitime dhe kreditime (3.000 paund).

Komisioni për këtë periudhë ka vlerësuar⁷³ se: [...] *lëvizjet në llogari nga ana e shtetasit A.A., nuk vërtetojnë të ardhura të ligjshme të tij, për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, si rrjedhim nuk janë marrë në konsideratë.*

b) Vërtetim i datës 12.02.2019⁷⁴, i shoqërisë "{***}", i shoqëruar me mandatpagesa prill 2016 - mars 2017 dhe prill 2017 - mars 2018, në emër të z. A.A.

Kolegji vëren se nga *payslips*⁷⁵ apo mandatpagesat për periudhën 08.04.2016 - 30.12.2016, z. A.A. ka të ardhura total në shumën 27.973 GBP.

⁷⁰ Përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 13.02.2019, nr. {***} prot., të Komisionit, pyetja 1.

⁷¹ Bashkëlidhur në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi {***}, pa vulë apostille.

⁷² Bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore paraprake, nga subjekti i rivlerësimit, nr. {***} prot., datë 01.04.2019, të Komisionit, me vulë apostille datë 01.03.2019, nga noteri Ch. D. G., në gjuhë angleze.

⁷³ Në vendim, faqe 28, paragrafi i tretë.

⁷⁴ Bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore paraprake, nga subjekti, nr. {***} prot., datë 01.04.2019, të Komisionit, me vulë apostille datë 01.03.2019, nga noteri Ch. D. G., në gjuhë angleze.

⁷⁵ "Payslip", përveç se në përgjigjet e rezultateve hetimore nr. {***} prot., dt. 01.04.2019, janë dorëzuar një pjesë nga subjekti i rivlerësimit dhe në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi {***}, pa vulë apostille, si dhe bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 dhe atij shtesë, dërguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 10.02.2019 me nr. {***} prot., dt. 13.02.2019, në Komision dhe nga subjekti i rivlerësimit në dt. 16.02.2019 me nr. {***} prot., dt. 20.02.2019, në Komision pa vulë apostille dhe të përkthyer në shqip me vërtetim përkthimi, dt. 09.02.2019, nr.

Komisioni ka vlerësuar⁷⁶ se: “i) listëpagesa nga sistemi kompjuterik, për periudhën e punësimit pranë “{***}”, nga data 01.07.2016 – 30.12.2016, të shtetasit A.A., nga të cilat rezulton se janë paguar sigurimet shoqërore dhe tatimet për të ardhurat në total në shumën prej 16.600 eurosh” dhe “[...] të ardhurat e deklaruara për vitin 2016, janë marrë në konsideratë, sipas deklarimit periodik për këtë vit, në shumën prej 6000 GBP, për shkak se subjekti i rivlerësimit vërtetoi me dokumentacion të rregullt ligjor, legalizuar me vulën *apostille* burimin nga të ardhura të ligjshme të vëllait të tij”.

Kolegji vëren se nga nxjerrjet e llogarisë bankare, rezultojnë të specifikuara vlerat e pagave, zbritjet nga tatimet dhe sigurimet shoqërore dhe, për pasojë, përbëjnë të ardhura të ligjshme.

Për këto arsye, Kolegji gjen të bazuar vlerësimin e Komisionit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A.A., për vitin 2016, sipas deklarimit periodik 2016, në shumën prej 6000 GBP.

36.10 Për këto arsye, Kolegji, sikurse Komisioni, gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të konsideruar si ardhura të ligjshme të ardhurat e të vëllait për vitet e tjera.

37. Lidhur me analizën financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit për sa u përket shpenzimeve të jetesës, me arsyetimin se Komisioni ka mbajtur të njëjtin standard me ILDKPKI-në për gjashtë persona⁷⁷, dhe se Komisioni nuk ka zbritur shpenzimet kur kanë qenë jashtë shtetit.

37.1 Kolegji vëren se Komisioni në përlllogaritjet e tij për shpenzimet e jetesës për periudhën 2003 - 2016 ka llogaritur shpenzime jetese në total në vlerën 11.089.286 lekë, duke e vlerësuar përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare⁷⁸. Kolegji vëren se, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konsideruar në përlllogaritjet e tij ecurinë e familjes sipas certifikatës familjare. Gjithashtu, Kolegji vëren se në vitin 2007, në llogaritjet e shpenzimeve të jetesës, Komisioni e ka konsideruar familje me katër persona, ndërkohë që sipas përbërjes familjare, familja ka qenë me pesë persona⁷⁹. Duke i llogaritur shpenzimet e jetesës, tashmë për pesë persona, dhe jo për katër persona, sikurse i ka llogaritur Komisioni, Kolegjit i rezulton se shpenzimet e jetesës së vitit do të ishin në një vlerë më të lartë, në shumën prej 803.571 lekësh, ndryshe nga llogaritja e Komisionit, në shumën prej 642.857 lekësh. Në këto kushte, analiza financiare e subjektit të

{***} rep. [vërtetimi i “{***}”, datë 27.10.2016 dhe payslip nga “{***}”, të vitit 2018 dhe 01.07.2016 - 30.12.2016].

⁷⁶ Në vendim, faqe 27, dhe faqe 28.

⁷⁷ Vendimi i Komisionit, faqe 29, pika 1: “[...] Lidhur me këtë pretendim, Komisioni konstatoi se është e vërtetë që shpenzimet e llogaritura nga ILDKPKI-ja (7.700.000 lekë), janë të përfaqësuara me shpenzimet e llogaritura nga subjekti i rivlerësimit (7.673.880 lekë). Por, ndërkohë që subjekti ka bërë llogaritjen për 6 persona, ILDKPKI-ja ka bërë llogaritjen për 4 persona. Duke mbajtur po të njëjtin standard si ILDKPKI-ja, por duke llogaritur shpenzimet jetike për 6 (gjashtë) persona, duke përfshirë dhe prindërit e subjektit, rezultoi që pretendimet e subjektit janë të pabazuara”.

⁷⁸ Shumën prej 9.000.000 lekësh, përpjesëtuar me 14 vjet = 642.857 lekë/vit, këtë shumë vjetore e ka përpjesëtuar me 4 për të përlllogaritur konsumin/person (= 160.714 lekë/person/vit) dhe shumëzuar me numrin e personave në familje [në vitin 2003 = 160.714 lekë x 3 persona = 482.143 lekë dhe për vitin 2004 po kështu, për vitet 2005, 2006, 2007 ka vendosur konsumin prej 642.857 lekësh për familje me 4 persona, në vitet 2008, 2009, 2010 = 160.714 lekë x 5 persona = 803.571 lekë dhe për vitet 2011 -2016 = 160.714 lekë x 6 persona = 964.286 lekë/vit.]

⁷⁹ Ashtu siç e ka përlllogaritur dhe vetë subjekti i rivlerësimit në analizën e tij në ankim.

rivlerësimit për këtë vit do të ndryshonte, nga vlera pozitive prej (+) 26811 lekësh⁸⁰, në vlerën negative prej (-) 133903 lekësh.

37.2 Subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në përgjigje të rezultateve hetimore paraprake, sipas analizës së tij, ka pretenduar për shpenzime jetese të përlllogaritura sipas publikimeve të INSTAT për Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ në vijim)⁸¹, për vitet që ka publikime dhe për vitet e tjera në të cilat nuk ka publikime ka konsideruar publikimet e fundit (të kësaj ankete), sipas përbërjes së familjes së tij ndër vite, për një total shpenzimesh jetese për periudhën 2003 - 2016 prej 7.673.880 lekësh. Kolegji konstaton se, referuar metodologjisë së anketimit nga INSTAT për Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ)⁸², sipas publikimeve⁸³ të tij, ka qëllime të ndryshme vrojtimi dhe monitorimi si për vlerësimin e trendit të varfërisë⁸⁴ dhe politikëbërjet e programeve sociale⁸⁵, e nuk kanë për qëllim matjen e konsumit për njësitë ekonomike familjare. Por, edhe nëse do të ishin konsideruar këto vlera të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur sërish do të rezultonin me diferenca negative ndër vite.

37.3 Kolegji, për të garantuar të drejtën e një analize financiare alternative, në vlerësim dhe të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e jetesës, ka vlerësuar se nëse do të konsideroheshin shpenzimet e jetesës sipas a) metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e dërguara nga Instituti i Statistikave (në vijim “INSTAT”)⁸⁶ sipas përbërjes së familjes së subjektit të rivlerësimit ndër vite, për periudhën 2003-2016 në total shpenzimet e jetesës do të ishin në vlerën 10.158.950 lekë⁸⁷, pra në një total më të madh se ato të aplikuar nga subjekti e më të vogla se ato të aplikuar nga Komisioni, por që sërish subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur do të rezultonin me diferenca negative ndër vite; por dhe b) sipas të dhënave të përdorura nga subjekti i rivlerësimit në analizë për vitet 2003-2005, me burim AMNJ, për të cilat

⁸⁰ Në analizën e vitit 2007, si rezultat i (a) të ardhurave për një total prej 1.622.700 lekësh [të ardhura nga subjekti i rivlerësimit 1.225.414 lekë + të ardhura bashkëshortja 204.488 lekë + të ardhura pensioni babai 192.798 lekë]; (b) pasurisë neto prej 743.047 lekësh [si diferencë e pasurisë për blerjen e automjetit Opel Vectra prej 376.365 lekësh – detyrime prej – 366.682 lekësh {si shumë e pagesës principal të kredisë {***}. Bank – 207.575 lekë dhe – 159.107 lekë e principalit të kredisë në {***} Bank}}]; (c) shpenzimeve për një total prej 814.672 lekësh [shumë e shpenzime jetese 642.857 lekë + interesave të kredisë në {***} Bank 92.864 lekë + interesave të kredisë në {***} Bank 78.951 lekë]; (ç) kursime prej 38.170 lekësh [si total i shtesës së likuiditeteve në bankë, si diferencë e gjendjeve të likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2007 – në fund të vitit 2006], pra (A)-(B)-(C)-(Ç) dhe me shifra [1.622.700 - 743.047 - 814.672 - 38.170 = + 26.811 lekë].

⁸¹ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-se-nivelit-te-jeteses-amnj/>

⁸² <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-se-nivelit-te-jeteses-amnj/>

⁸³ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-s-%c3%ab-nivelit-t-%c3%ab-jetes-%c3%abs-amnj/>

⁸⁴ http://www.instat.gov.al/media/2065/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2012_rishikuar.pdf

⁸⁵ “Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) është një anketë shumëqëllimëshe, e kryer pranë familjes, dhe deri në vitin 2012 ka qenë një nga burimet kryesore të informacionit për të matur kushtet e jetesës, situatën e varfërisë dhe për të siguruar një mjet të domosdoshëm për të ndihmuar hartuesit e politikave në monitorimin dhe hartimin e programeve sociale. Matjet e nevojshme janë bërë duke u mbështetur te konsumi i familjeve”. <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-se-nivelit-te-jeteses-amnj/>

⁸⁶ Shkresën e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 04.03.2019, dërguar Kolegjit.

⁸⁷ Si total i shpenzimeve të jetesës për familje: me 3 persona për vitet 2003 dhe 2004, në shumat prej 281.592 lekësh secili vit, me 4 persona për vitet 2005 dhe 2006, në shumat prej 438.228 lekësh secili vit, me 5+ persona për vitin 2007, në shumën 1.179.840 lekë dhe për vitet 2008-2011 me 683.100 lekë secili vit, në vitet 2012-2013 me shpenzime prej 705.120 lekësh secili vit, në vitin 2013 me shpenzime prej 1.099.990 lekësh, në vitin 2015 prej 1.121.380 lekësh dhe në vitin 2016 prej 1.175.460 lekësh.

nuk ka publikime nga INSTAT për “Shpenzime mujore për konsum sipas madhësisë së njësisë ekonomike familjare” (në vijim “NjEF”) dhe për vitet e tjera sipas të dhënave të “Shpenzimeve mujore për konsum sipas madhësisë së njësisë ekonomike familjare” (në vijim “NjEF”)⁸⁸, të afektuar me inflacionin e përllogaritur sipas Indeksit të Çmimeve të Konsumit (ndryshimin mesatar vjetor të çmimeve të shportës), të publikuar nga INSTAT⁸⁹, për periudhën 2003-2016, në total shpenzimet e jetesës do të ishin në vlerën 11 347.472 lekë, pra me një total më të lartë se ai i aplikuar nga Komisioni dhe i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, i cili do të përkeqësonte rezultatet financiare ndër vite për subjektin e rivlerësimit.

37.4 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se “Komisioni ka mungesë të theksuar në vlerësim dhe arsyetim, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka përdorur vetëm një herë kartën e kreditit, por më shumë se një herë, e se shpenzimet e kartës kreditit janë përllogaritur në shpenzimet e udhëtimeve TIMS e nuk duhen publikuar”, në vlerësim të analizës financiare të kryer në Komision, i cili ka reflektuar ndryshime në analizën financiare pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit të rezultateve hetimore paraprahe vetëm në vitin 2011, përfshirë informacionin që gjendet në dosjen e ardhur nga Komisioni për sa u përket lëvizjeve të llogarisë së kartës së kreditit të subjektit të rivlerësimit në {***} Bank⁹⁰ dhe raportit të udhëtimeve sipas sistemit TIMS, u analizuan shpenzimet e kryera me kartë krediti në vitet e tjera, 2012 -2016. Konstatohet se referuar për aq sa përskrime ka në lëvizjet e llogarisë së kartës së kreditit dhe informacionit në TIMS, ka shpenzime me kartë krediti që nuk zëvendësojnë shpenzimet e konsideruara nga Komisioni për udhëtim dhe qëndrim, por rezultojnë se ka shpenzime ekstra të cilat nuk përkojnë me datat e udhëtimeve⁹¹, ka shpenzime me kartë krediti që përkojnë me datat e udhëtimeve, por Komisioni nuk i ka llogaritur kosto udhëtimi⁹² apo shpenzime për blerje, kryer jashtë vendit⁹³, apo pagesa për linja fluturimi⁹⁴ me të cilat, sipas raportit TIMS në ato vite, subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e fëmijët nuk kanë udhëtuar me avion apo dhe me ato linja fluturimi. Kolegji, referuar sa më sipër, vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi shpenzimet me kartë krediti nuk zëvendësojnë shpenzimet e konsideruara nga Komisioni në analizë për udhëtimet sipas raportit TIMS (shpenzime transporti dhe qëndrimi). Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se: “Komisioni nuk zbret shpenzimet kur je jashtë shtetit, pra kosto vjetore konsideron çdo ditë në Shqipëri, pastaj i shtohen dhe ato jashtë shtetit, d.m.th. ekspertiza e rreme e KPK konkludon që njeriu është njëherësh (fle, ha, pi, blen) brenda dhe jashtë shtetit. Kjo përbën më shumë se shtrembërim të fakteve”, Kolegji konstaton se shpenzimet e jetesës në Shqipëri, sipas publikimeve të INSTAT⁹⁵, janë me bazë

⁸⁸ Shih: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab2>

⁸⁹ Shih:

http://databaza.instat.gov.al/px/eb/sq/DST/START_PR_PRCPI/CPI006/table/tableViewLayout2/?rxid=eae798d2-a24d-44f0-9c9c-3909a5be39bd

⁹⁰ Bashkëlidhur shkresa kthim përgjigjeje nr. {***} prot., 10.04.2018, nga {***} Bank, në dosjen e Komisionit.

⁹¹ Në vitin 2016, kur udhëtimet janë kryer më 15 - 16.6.2016, me charter në Francë; më 27.07 - 16.08.2016, me destinacion Anglinë; subjekti i rivlerësimit me familjen 21 - 24.8.2016, me destinacion Greqinë, nga pika kufitare Qafë Botë/Kakavijë me makinën e tyre; dhe 22 - 28.12.2016, subjekti i rivlerësimit me familjen e tij, me destinacion Greqinë, nga pika kufitare Qafë Bota. Ndërsa shpenzimet me kartë krediti janë në 30.04.2016, 23.07.2016, 08.06.2016. Në prill të vitit 2013, shpenzime për të cilat përshkrimet nuk përkojnë me shpenzime udhëtimi (kosto udhëtimi apo qëndrimi).

⁹² Në vitin 2015, me destinacion Maqedoninë, pika kufitare Tushemisht.

⁹³ Në prill të vitit 2013; në shkurt të vitit 2014; në janar të vitit 2015.

⁹⁴ Ka shpenzime me kartë krediti: në vitin 2012 me përshkrimin “{***}”, “{***}”; në vitin 2013 me përshkrimin “{***}”, “{***}”.

⁹⁵ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-të-familjes/>

shpenzimesh mesatare mujore, sipas të dhënave në bazë anketash të kryera në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shpenzimet mujore përbëjnë totalin e shpenzimeve të disa grupeve të konsumit ku përfshihen shpenzimet për “ushqim dhe pije joalkoolike”, “banesën, uji, energji elektrike etj.”, “mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës”, “arsim” etj. Referuar tipologjisë së nëngrupeve të konsumit, konstatohet se një pjesë e shpenzimeve nuk afektohen nga udhëtimet disaditore që subjekti i rivlerësimit/familja e tij ka kryer pasi janë shpenzime të cilat vazhdojnë e gjenerohen. Për sa u përket shpenzimeve të grupit të konsumit “ushqim dhe pije joalkoolike”, të cilat sipas publikimeve të INSTAT⁹⁶ përbëhen nga nëngrupet “mish dhe nënprodukte”, “qumështi, vezët dhe nënproduktet e tij”, “bukë dhe drithëra”, “perimet” dhe “frutat”, rezultoi se disa nga shpenzimet bazike të kësaj kategorie përbëjnë konsum më të gjatë në kohë. Në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë, përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, Kolegji vlerëson se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste.

37.5 Referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me detyrimin e Komisionit për të konsideruar likuiditetet në institucionet bankare pasi janë reale dhe të ligjshme dhe Komisioni ka detyrimin t’i marrë në konsideratë, konstatohet se Komisioni në analizën financiare, në raportin e rezultateve paraprake hetimore, dërguar subjektit i rivlerësimit, në pasqyrën financiare totale të periudhës 2003-2016, i ka përfshirë shtimet/pakësimet e likuiditeteve në institucionet bankare në seksionin “Kursime” për vitet 2003-2016 dhe në vitet 2014 dhe 2016 ka konsideruar, plus, dhe shtimet e likuiditeteve në “cash”, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat vjetore 2014 dhe 2016. Gjithashtu, Komisioni e ka konfirmuar këtë edhe në vendim, në seksionin “Metodologjia e përdorur në analizën financiare”⁹⁷, në të cilën u është referuar edhe shkresave të institucioneve bankare nga të cilat janë konfirmuar likuiditetet në banka. Ndërkohë, edhe vetë subjekti i rivlerësimit në analizën financiare në ankim (në faqen 72 të saj), në përgjigjet e rezultateve hetimore⁹⁸ dhe në raportin e vlerësimit kontabël, datë 23.03.2019, përgatitur nga eksperti kontabël⁹⁹ bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, ka përfshirë diferencat e likuiditeteve në banka [te seksioni “Pasuri”, me përshkrimin “Diferenca likuiditeti”], të cilat janë të njëjta me vlerat e konsideruara nga Komisioni në analizë për gjithë periudhën.

37.6 Për këto arsye, nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me analizën financiare të Komisionit.

- 38.** Lidhur me analizën financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, Kolegji konstaton e vlerëson sa më poshtë.

38.1 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nga Komisioni, në analizë, nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga investimet në depozita me afat në monedhën lekë, euro apo të tjera, të ardhurat nga investimet në fondet e investimeve, Kolegji vëren se, referuar analizës

⁹⁶ http://www.instat.gov.al/media/2067/buxheti_i_familjes.pdf

⁹⁷ Shih vendimin e Komisionit, faqe 30-31, pika a.

⁹⁸ Nr. {***} prot., datë 01.04.2019 të Komisionit, në analizën financiare në tabelë (faqe 49) për të gjithë periudhën 2003 - 2016.

⁹⁹ Eksperti kontabël, z. B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij, në tabelën financiare për të gjithë periudhën 2003-2016.

financiare të Komisionit, nuk janë përlllogaritur të ardhurat nga interesat e depozitave, por edhe subjekti i rivlerësimit në analizën financiare në ankim (në faqen 72 të saj), në përgjigjet e rezultateve hetimore¹⁰⁰ nuk ka përfshirë të ardhura nga interesat e depozitave bankare, e vetëm ka përshkruar në raportin e vlerësimit kontabël, datë 23.03.2019, përgatitur nga eksperti kontabël¹⁰¹, se nuk i ka përfshirë këto të ardhura. Nga analiza financiare e kryer, përfshirë informacionin që gjendet në dosjen e ardhur nga Komisioni, e përlllogaritjet në Kolegj, të ardhurat nga interesat e depozitave ndër vite, nga 2006-2016, janë në një shumë totale prej 186735 lekësh¹⁰². Përfshirja e tyre do të përmirësonte situatën financiare, por jo në atë masë për të ndryshuar rezultatet e analizave financiare të viteve, nga pamjaftueshmëri në mjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme për të përballuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara.

38.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se nuk është ndërhyrë në analizën financiare në vendim (“përmenden vetëm 1000 euro të automjetit që nuk u ble, “sajuar” nga Komisioni dhe të ardhurat nga im vëlla për vitin 2016”), edhe pse dokumentet ishin me vulë *apostille*, Kolegji konstaton se Komisioni i ka reflektuar ndryshimet në analizën financiare pas paraqitjes së pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve hetimore paraprake, siç përmend dhe vetë subjekti i rivlerësimit në ankim, mbi shpenzimin e konsideruar për blerjen e makinës Volkswagen Golf në vitin 2014 (për shumën 1.000 euro), për të cilin, pas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se kontrata është anuluar duke mos u regjistruar në DPSHTRR, nuk është përfshirë si shpenzim në analizën e vitit¹⁰³; për të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar për to në vendim për përfshirjen e të ardhurave të deklaruara në vitin 2016¹⁰⁴, si dhe është arsyetuar mbi të ardhurat për vitet e tjera¹⁰⁵. Pra, konstatohet se Komisioni ka reflektuar ndryshimet në analizën financiare, pas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve hetimore paraprake, në paraqitjen tabelare të analizës financiare për vitet 2003-2004, ku diferenca (të ardhura – pasuri – shpenzime 4-3-5) në vendim është (+) 1.103.230 lekë dhe në paraqitjen tabelare, në analizën sipas raportit të rezultateve hetimore ishte (+) 1.086.710 lekë, si rezultat i konsiderimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e interesave të kredisë në {***} Bank (për vitet 2003-2004, ndryshuar nga 386.090 lekë në 369.569 lekë); në paraqitjen tabelare të analizës financiare për vitin 2012, ku diferenca (të ardhura – pasuri – shpenzime 4-3-5) në vendim është (-) 886.863 lekë dhe në paraqitjen tabelare në analizën sipas raportit të rezultateve hetimore ishte (-) 912.224 lekë, pra është ulur diferenca negative si rezultat i konsiderimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për më tepër duket dhe në rezultatin total të analizës financiare të periudhës 2003-2016, ku në vendim Komisioni shprehet se ka një diferencë të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën prej (-) 2.473.568 lekësh, ndërsa në raportin e rezultateve hetimore kjo diferencë ishte më e lartë (- 3.082.877 lekë), dhe me reflektimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit situata financiare u përmirësua, megjithëse sërish mbeti me diferencë të pajustificuar. Pra, referuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka ndërhyrë në analizën financiare në vendim.

¹⁰⁰ Nr. {***} prot., datë 01.04.2019 të Komisionit, në analizën financiare në tabelë (faqe 49) për të gjithë periudhën 2003 - 2016.

¹⁰¹ Eksperti kontabël, z. B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij, poshtë tabelës financiare për të gjithë periudhën 2003 - 2016.

¹⁰² Sipas lëvizjes së llogarive bankare në {***} Bank, {***} Bank, {***} Bank, {***} Bank.

¹⁰³ Referuar në vendim, faqe 26, paragrafi nr. 4.

¹⁰⁴ Referuar në vendim, faqe 28, paragrafi i dytë dhe te seksioni “Analiza financiare”, faqe 29, paragrafi i dytë.

¹⁰⁵ Në vendim, faqe 27, paragrafi nr. 6.

38.3 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nga dy shitje automjetesh nuk janë llogaritur nga Komisioni në analizën financiare si të ardhura shumat 3500 euro dhe 2.000.000 lekë, Kolegji vëren se shuma prej 3500 eurosh lidhet me shitjen e automjetit Opel Vectra, i vitit 1998, {***}, në vitin 2010. Sipas analizës financiare, në raportin e rezultateve paraprake hetimore dërguar subjektit të rivlerësimit, në pasqyrën financiare totale të periudhës 2003-2016, Komisioni e ka përfshirë vlerën e shitjes së makinës si të ardhur në shumën 376.365 lekë, në seksionin “Pasuri”, në analizën e vitit 2010 me vlerë negative, pra si hyrje/e ardhur, si dhe në seksionin “Të ardhura” në analizën e vitit 2010, me përshkrimin “Të ardhura nga shitja makinës”, në shumën 109.470 lekë, si diferencë e çmimit të shitjes 3500 euro (ekuivalenti në lekë 485.385) me çmimin e blerjes 376.365 lekë (ekuivalenti në lekë i çmimit të deklaruar në deklaratën vjetore 2007, 1.500 euro dhe 195.000 lekë, deklaruar si shpenzime për zhdoganimin). Pra, referuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim, se shitja e automjetit (në shumën 3500 euro) nuk është llogaritur si e ardhur. Për më tepër që dhe vetë subjekti i rivlerësimit në analizën financiare në ankim (në faqen 72 të saj), në përgjigjet e rezultateve hetimore¹⁰⁶ dhe në raportin e vlerësimit kontabël, datë 23.03.2019, përgatitur nga eksperti kontabël¹⁰⁷ bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, ka bërë të njëjtën paraqitje dhe përfshirje të të ardhurave nga shitja.

38.4 Kolegji gjithashtu vëren se Komisioni ka përfshirë si të ardhur edhe diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes. Në kushtet kur në aktet në dosjen e subjektit të rivlerësimit, ardhur nga Komisioni, nuk provohet pagesa e detyrimit tatimor për vlerën e fituar (çmimi i shitjes minus çmimi i blerjes), Komisioni nuk duhet ta kishte konsideruar si të ardhur të ligjshme diferencën midis çmimit të shitjes me çmimin e blerjes, kjo në vijim edhe të jurisprudencës së Kolegjit në raste të ngjashme¹⁰⁸.

38.5 Për sa i përket shitjes së automjetit, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i janë llogaritur të ardhurat prej 2.000.000 lekësh, Kolegji vëren se nuk ka në deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit apo gjatë hetimit administrativ në Komision një automjet që të jetë shitur me këtë vlerë. Por, nëse do të konsiderohet se mund të jetë lapsus shuma e vendosur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, pra jo 2.000.000 lekë, por 200.000 lekë, lidhet me shitjen e automjetit Rover/XHLS {***}, në vitin 2008. Sipas analizës financiare në raportin e rezultateve paraprake hetimore, dërguar subjektit të rivlerësimit, në pasqyrën financiare totale të periudhës 2003-2016, Komisioni e ka përfshirë vlerën e shitjes së makinës si të ardhur në shumën 200.000 lekë, në seksionin “Pasuri”, në analizën e vitit 2008, me vlerë negative, pra si hyrje/e ardhur. Pra, referuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim se shitja e automjetit nuk është llogaritur si e ardhur. Për më tepër që dhe vetë subjekti i rivlerësimit, në analizën financiare në ankim (në faqen 72 të saj), në përgjigjet e rezultateve hetimore¹⁰⁹ dhe në raportin e vlerësimit kontabël, datë 23.03.2019¹¹⁰, bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, ka bërë të njëjtën paraqitje dhe përfshirje të të ardhurave nga shitja.

¹⁰⁶ Nr. {***} prot., datë 01.04.2019 të Komisionit, në analizën financiare në tabelë (faqe 49) për të gjithë periudhën 2003-2016.

¹⁰⁷ Eksperti kontabël, z. B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij në tabelën financiare për të gjithë periudhën 2003-2016.

¹⁰⁸ Referojuni vendimeve të Kolegjit nr. 11, datë 22.05.2019, për subjektin e rivlerësimit Edmond Islamaj, paragrafi 27.12.12; dhe nr. 34/2019, datë 02.12.2019, për subjektin e rivlerësimit Entela Prifti, paragrafi 65.4.

¹⁰⁹ Nr. {***} prot., datë 01.04.2019 të Komisionit, në analizën financiare në tabelë (faqe 49) për të gjithë periudhën 2003-2016.

38.6 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për udhëtimet brenda ditës, për të cilat Komisioni në analizën financiare ka përlllogaritur shpenzime udhëtimi e nuk ka bërë interpretimin më të thjeshtë¹¹¹, konstatohet se Komisioni nuk ka përlllogaritur shpenzime për subjektin e rivlerësimit për udhëtimet disaorëshe, gjatë gjithë periudhës së analizës, ashtu dhe për vitin 2015, me pikë kufitare, dalje/hyrje, Qafë Thanë dhe/ose Tushemisht, gjithsej për 13 udhëtime të tilla nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, të cilat nuk janë përfshirë si shpenzime në analizë, në zërin e shpenzimeve të udhëtimit TIMS. Pra, Kolegji, vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

38.7 Për këto arsye, Kolegjit i rezulton se edhe nëse do të përfshiheshin në analizë të ardhurat e pretenduara në ankim, sërish subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me diferenca negative të paktën në vlerën e konstatuar nga Komisioni në vendimin e tij, përkatësisht në vlerën prej (-) 2473.568 lekësh, dhe për këtë arsye Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte plotësisht shpenzimet e pasuritë e vendosura me të ardhura të ligjshme.

- 39.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk rezulton asnjë përlllogaritje për deklaramë shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë që të mund të përafrojnë minimalisht vendimmarrjen për shkarkimin e tij, Kolegji vlerëson se deklarimi i më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, është vetëm një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, si shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit në këtë rast, ka përdorur paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

39.1 Verifikimi i saktësisë dhe plotësisë së deklaramëve të subjektit të rivlerësimit, verifikimi i dyfishit të pasurisë, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklaramëve vlerën e provës, përbëjnë në fakt kriteret në të cilat duhet të kalojë vlerësimi i pasurive të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës¹¹². Kolegji vëren se secili nga paragrafët e nenit D të Aneksit të Kushtetutës normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit. Konkretisht, *pika 1* parashikon qëllimin e kontrollit të pasurisë dhe të deklaramit, identifikimin e subjekteve të rivlerësimit që kanë pasuri të pajustificuar ose të subjekteve të rivlerësimit që nuk kanë deklaruar saktë dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe ato të personave të lidhur; *pika 2* parashikon detyrimin për plotësimin e saktë dhe të plotë të deklaramës *vetting* dhe detyrimin e ILDKPKI-së për të përpiluar një raport për ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklaramit sipas ligjit; *pika 3* parashikon detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaramara; *pika 4* parashikon se nëse deklarohet pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, subjekti i rivlerësimit prezumohet fajtor për shkelje disiplinore dhe duhet të paraqesë prova që të vërtetojnë të kundërtën; dhe *pika 5* parashikon rastin e mosdorëzimit të deklaramës në kohë, apo përpjekjes për të fshehur, apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, gjë e cila shkakton prezumimin e masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të paraqesë prova që vërtetojnë të kundërtën.

¹¹⁰ Eksperti kontabël, z. B. H., me licencë nr. {***}, në faqen 11 të raportit dhe bashkëlidhur tij në tabelën financiare për të gjithë periudhën 2003-2016.

¹¹¹ Duke theksuar udhëtimet e kryera brenda ditës në vitin 2015 për përdorimin e rrugës Tushemisht - Qafë Thanë nga ana e Maqedonisë, e cila është përdorur për shkak të rrugës në ndërtim në hyrje të Pogradecit e për të cilat i janë llogaritur shpenzime udhëtimi e duke u konsideruar si turizëm.

¹¹² Shih pikën 12.2 të vendimit nr. 9, datë 18.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

39.2 Në përmbledhje, secila prej këtyre pjesëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, “pavarësi” e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, ky nen zberthen secilën prej pikave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke e materializuar sanksionimin kushtetues edhe me përcaktimin konkret të shkeljes. Më konkretisht, pika 1 e nenit 61 përcakton si shkelje “deklarimin më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të”; pika 2 përcakton si shkelje “problemet serioze që lidhen me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar”, çka ndikon në kontrollin e figurës; pika 3 përcakton si shkelje “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të figurës” dhe “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të pasurisë”; pika 4 “përshtatshmërinë për shkak të nivelit të aftësive profesionale”; dhe pika 5 përcakton si shkelje “cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë”. Sikurse rezulton nga ky zberthim, pikat 3 dhe 4 të nenit D të Kushtetutës janë pasqyruar në parashikimet 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë. Të dyja këto raste rrjedhin nga situata specifike të veçanta dhe nuk mund të konsiderohet se zbatohen në mënyrë kumulative¹¹³.

40. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në kuptim të ligjit dhe udhëzimit të ILDKPKI-së, ka një trajtim të veçantë ligjor për personat emigrantë¹¹⁴, sikurse rasti konkret për vëllain e tij, z. A.A., Kolegji vlerëson se legjislacioni i rivlerësimit në tërësi, kërkon justifikimin e të ardhurave me burime të ligjshme, pavarësisht prejardhjes ose jo nga emigracioni, apo gjendjes brenda apo jashtë vendit.

40.1 Nëpërmjet pikës 25 të udhëzimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, udhëzohen subjektet e rivlerësimit se, nëse ata vetë dhe/ose personat e lidhur me ta, kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të paraqesin deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë, si dhe dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë vendit.

41. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se deklarimi i rremë i pasurisë bëhet me dashje dhe vetëm për pasuritë e deklaruara, të cilat janë fituar nga burime të paligjshme, sepse nuk ekziston logjika juridike që bëhet deklaratë e rreme nga burime të ligjshme e të justifikuara, Kolegji vlerëson se nuk mund të rëndohet subjekti i rivlerësimit vetëm për pjesën e personit të lidhur, nëse ky i fundit nuk deklaron të vërtetën apo ka kryer deklaram të rremë, por vetëm pas vlerësimit në tërësi të rrethanave të çështjes.

41.1 Duke i vlerësuar në tërësi rrethanat e çështjes, Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitet 2004 - 2015¹¹⁵, të ardhura të krijuara nga vëllai i tij A.A.. Nga inventari i

¹¹³ Shih pikën 22.15 të vendimit nr. 19, datë 26.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹¹⁴ Që nuk kanë lidhje me asnjë aktivitet në Shqipëri dhe vijnë vetëm me pushime, aq më tepër kur kanë dhe shtetësi tjetër, duke iu referuar vlerësimit të Komisionit për deklarim të rremë në deklaratën vetting për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave në emigracion të vëllait, z. A.A.

¹¹⁵ Përkatësisht: i) për vitin 2004, të ardhura nga emigracioni në shumën 550.000 lekë, Angli; ii) për vitin 2005, të ardhura nga z. A.A., emigrant 2.000 GBP; iii) për vitin 2006, të ardhura nga z. A.A., emigrant, nga puna 2.000 GBP; iv) për vitin 2007, të ardhura nga emigracioni, z. A.A., 3.000 GBP; v) për vitin 2008, të ardhura nga z. A.A., emigrant, 1.200 GBP; vi) për vitin 2009, të ardhura nga z. A.A., emigrant, 4.500 GBP; vii) për vitin 2010, të ardhura nga z. A.A., nga emigracioni, 2.500 GBP; viii) për vitin 2011, të ardhura nga z. A.A., nga emigracioni, 1.200 GBP; ix) për vitin 2012, të ardhura nga z. A.A., nga emigracioni, 2.000 GBP; x) për vitin 2013, të ardhura

dokumentacionit të dorëzuar në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë të dhëna pasurore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit për vëllain e tij, z. A.A.

41.2 Kolegji vlerëson se paraqitja e të dhënave pasurore të të vëllait, z. A.A., jo në deklaratën *vetting*, por nëpërmjet dokumenteve që shoqëronin deklaratën *vetting*, dhe më pas gjatë hetimit administrativ, dëshmojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Fakti që personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor, e bën deklaratën e pasurisë *vetting* të pasaktë në drejtim të deklaratimeve të saj dhe në zbatimin *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit nën parashikimin e kësaj pike¹¹⁶.

41.3 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të cituar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm, Kolegji vlerëson se sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Formulari i deklarimit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 – vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar ndërsa vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur¹¹⁷.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe të çështjes në tërësi

42. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka mbivendosur në mënyrë alogjike paragrafët 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas tij, të njëjtat fakte të pretenduara, përveçse të pavërteta, nuk mund të kenë përcaktime juridike të ndryshme, Kolegjit i rezulton se për pjesën që i përket vlerësimit të pasurive, faktet të cilat i kanë shërbyer konkluzionit të arritur nga Komisioni për deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit, i kanë shërbyer edhe konkluzionit për vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit, 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa për pjesën që i përket vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni nuk ka arritur në një përfundim, por mbi faktet që kanë rezultuar nga kjo procedurë, i kanë shërbyer gjithashtu Komisionit për vlerësimin tërësor të çështjes.

nga z. A.A., nga emigracioni, 1.800 GBP; xi) për vitin 2014, të ardhura nga z. A.A., nga emigracioni, 3.000 GBP; xii) për vitin 2015, të ardhura nga z. A.A., nga emigracioni, 1.800 GBP; xiii) për vitin 2016, të ardhura nga z. A.A., nga emigracioni, 6.000 GBP.

¹¹⁶ Shih vendimin nr. 9/2020(JR), datë 28.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 14.2.

¹¹⁷ Shih vendimi nr. 21/2020(JR), datë 10.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 51.

42.1 Kolegji vlerëson se nëse nga vlerësimi tërësor i procedurave, do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit kishte cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, kjo do të përbente shkak të pavarur shkarkimi nga detyra, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji arsyeton se faktet që i kanë shërbyer Komisionit për vlerësimin e pasurive dhe arritjes së konkluzionit, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si një element specifik, në kuptim të termit “pavarësi” të trajtuar nga Kolegji në jurisprudencën e tij, duke e materializuar sanksionimin kushtetues edhe me përcaktimin konkret të shkeljes dhe të pasojës përkatëse, përjashton mundësinë e përfshirjes në mënyrë kumulative të këtyre fakteve sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

43. Lidhur me qiramarrjen e datës 03.05.2012, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe {***}, Bashkia Vlorë, të tokës bujqësore në fshatin {***}, Vlorë, me sip. 0,5 ha, me qira vjetore 5.000 lekë, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk është në etikën e një prokurori vijimi i një marrëdhënieje juridike, të cilin ligji aktual e ndalon, duke pretenduar se nuk ka asnjë konflikt ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të tij në ushtrimin e funksionit pasi nuk ka praktikisht asnjë mundësi, sipas tij, që ai të trajtojë aktualisht raste me natyrë penale apo civile, në këtë kuptim, që lidhen me autoritetin qiradhënës apo rastin, dhe as nuk ka ndodhur të ketë trajtime apo veprime preferenciale.

43.1 Kolegji vëren se në datën 03.05.2012, kur kontrata e qirasë është lidhur, ligji nr. 9367/2005, nuk e parashikonte atë si ndalim për prokurorët, dhe se ky ndalim u parashikua me ligjin nr. 44/2014, datë 24.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar¹¹⁸.

43.2 Kolegji vlerëson se sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit. Kolegjit nuk i rezulton që vazhdimi i marrëdhënieve kontraktore të qirasë të lidhur në një kohë më të hershme ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe {***}, Bashkia Vlorë, kur ajo nuk ndalohej nga ligji i kohës, të jetë shkelje e etikës.

44. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se mosheqja dorë nga shqyrtimi i çështjes që i përkiste z. F.D., si dhe qëndrimi mohues për njohjen me z. F.D., vinte në kundërshtim me etikën e një prokurori, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka manifestuar lajthitje të rëndë juridike, duke pretenduar se ai rast kishte largësi kohore dhe ishte jashtë periudhës së rivlerësimit.

44.1 Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (në vijim “PPGjShPV”) në procedimin penal nr. {***}¹¹⁹ kundër z. F.D., në përfundim të të cilit ai u dënua me gjobë 300.000 lekë, për kryerjen e veprës penale të armëmbajtjes pa leje¹²⁰. Hetimi i rrethanave çështjes penale në ngarkim të z. F.D.¹²¹ nga subjekti

¹¹⁸ Sipas të cilit, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, nuk mund të lidhin kontrata ose nënkontrata me asnjë institucion publik.

¹¹⁹ Rezulton se z. F.D. është gjykuar në mungesë dhe është dënua me gjobë 300.000 lekë për kryerjen e veprës penale të armëmbajtjes pa leje.

¹²⁰ Nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 28.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

i rivlerësimit, çojnë në përfundimin se ai ishte duke hetuar një person me të cilin rezultojnë të kishin njohje.

44.2 Kolegji vlerëson se vendimtare për heqjen dorë të prokurorit është nëse do të rezultojnë dyshime objektive për paanësi mjaftueshmërisht të bazuara¹²², si dhe rastet e parashikuara në nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale. Vetëm rrethanat e njohjes me personin e proceduar, të shkëputura, nuk vërtetojnë faktin që prokurori ishte në kushtet e heqjes dorë për këtë çështje, ndërkohë që nuk rezultojnë faktin që subjekti i rivlerësimit, duke ushtruar funksionin e prokurorit, të mos ketë ofruar garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim¹²³.

44.3 Në lidhje me Konkluzionin për shkelje të etikës, Kolegji vlerëson se sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

45. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se qëndrimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit¹²⁴, në lidhje me njohjen me z. E.M., nuk janë në etikën e një prokurori, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ai ka udhëtuar me z. E.M. në vitin 2014 dhe jo në vitin 2016, që pretendohet që ka qenë dënuar disa herë, se është jashtë periudhës së rivlerësimit dhe nuk ka asnjë lidhje me kriterin profesional.

45.1 Kolegjit i rezultojnë se Komisioni ka konstatuar se në datën 30.03.2014, subjekti i rivlerësimit ka kaluar kufirin shqiptar nga pika kufitare e Morinës, Kosovë, me automjetin me targa {***}, në pronësi në z. E.M., dhe ka hyrë në territorin shqiptar po nga kjo pikë kalimi dhe me të njëjtin automjet në datën 01.04.2014¹²⁵. Kolegjit nuk i rezultojnë që z. E.M. të jetë proceduar penalisht apo të jetë dënuar përpara kohës që ka udhëtuar në drejtim të Kosovës me subjektin e rivlerësimit.

45.2 Në lidhje me konkluzionin për shkelje të etikës, Kolegji vlerëson se sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit. Kolegji vlerëson se

¹²¹ Nga kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2011, e prokurorit Edison Ademi, pranë PPGjShPV-së, rezultojnë se: "Në Vlorë, në datën 30.01.2011, unë Edison Ademi, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi studiova aktet në procedimin penal nr. {***} të vitit 2011, në ngarkim të të pandehurit: F.D., bir i M. e T., datëlindja {***}, lindur në Vlorë, banues në lagjen "{***}", Vlorë, me kombësi e shtetësi shqiptare, i martuar, e vetëpunësuar në tregti, arsimit mesëm, tel. {***}, arrestuar në flagrancë në datën 27.11.2011, ora 18:00, hetuar nën masën e sigurimit garancia pasurore, e parashikuar në nenin 236 të KPrPenale, mbrojtur prej avokatit të zgjedhur. [...]", dhe në përfundim: "Kërkesë, gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2011, ndaj të pandehurit F.D., akuzuar për kryerjen e veprës penale prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit, e parashikuar nga neni 278 i KPenal".

¹²² Shih vendimin e GjEDNj-së në çështjen "Driza kundër Shqipërisë".

¹²³ Shih vendimin e GjEDNj-së në çështjen "Gjonboçari etj. kundër Shqipërisë".

¹²⁴ Nga njëra anë, në përgjigje të pyetësorit të datës 06.03.2019, subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar se nuk kishte dhe nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënieje interesi, dhe nga ana tjetër se lëvizja për në Kosovë kishte qenë, me sa kujtoonte, për interesin e tij që të prenotonte llixhat e nënës së tij.

¹²⁵ Shih pikën 3.2, f. 36 e vendimit të Komisionit.

qëndrimi mohues i subjektit të rivlerësimit për njohjen me z. F.D., i vlerësuar në tërësi edhe në raport me largësinë kohore të procedimit penal, nuk përbën shkelje të etikës nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit.

46. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji arriti në përfundimin se në rastin në gjykim, konkluzionet e sipërcituara të Komisionit janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të tij, me mosheqjen dorë nga një kontratë e lidhur me një institucion publik që nuk ndalohej me ligj për t'u lidhur, me ushtrimin e funksionit të prokurorit në çështjen penale të sipërpërmendur, si dhe me udhëtimin me një person që nuk rezultonte i dënuar për vepër penale në kohën e udhëtimit, ka cenuar besimin e publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

47. Në përfundim, sikurse Komisioni, edhe Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të pasakta, të paplota dhe të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë.. Dhe, edhe nëse do të konsideroheshin nga Kolegji shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, sërish do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e tij dhe të personit të lidhur, madje me diferencë negative edhe më të thelluar në disa raste. Faktet e konstatuara nga Komisioni në raport me kërkesat ligjore, nga Kolegji u gjendën të mjaftueshme për të mbështetur vendimmarrjen e Komisionit.
48. Kolegji, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit lidhur me provat e administruara në këtë çështje, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në konkluzionet se:
- I. Subjekti i rivlerësimit Edison Ademi rezulton se ka bërë deklaratim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në disa vite dhe, si rrjedhojë e kësaj situatë faktike, në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, germet “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
 - II. Trupit gjykues, megjithëse i rezultuan të bazuara disa prej shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
 - III. Në përfundim, Kolegji, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çmon se vendimi i Komisionit nr. 137, datë 09.04.2019, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 137, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.11.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

Mendim paralel

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, ndërsa jam dakord me shumicën për mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [nr. 137, datë 09.04.2019] që vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, parashtror mendimin tim paralel për dy aspekte për të cilat nuk jam dakord me shumicën.
2. Së pari, vlerësoj se konkluzioni i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se subjekti i rivlerësimit Edison Ademi ishte në gjendje konflikti i interesit që nga viti 2014, në lidhje me pasurinë tokë arë në Nartë të marrë me qira, ishte i drejtë dhe duhej të konfirmohej në Kolegj. Së dyti, edhe konkluzioni i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut si pasojë e lidhjeve të tij të dokumentuara në kohë të ndryshme me dy individë të përfshirë në veprimtari kriminale, ishte i drejtë. Për të dyja këto dy aspekte, isha e mendimit që në zgjidhjen përfundimtare, trupi gjyqësor i Kolegjit duhej të bazohej në lënien në fuqi të masës së shkarkimit edhe sipas paragrafit 5 të nenit 61, përpos paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

A. Konflikti i interesit

3. Për sa i përket çështjes së konfliktit të interesit, pyetja që duhej shtruar në rrethanat konkrete, ishte: A ishte i detyruar me ligj subjekti i rivlerësimit të merrte masat e nevojshme për të zgjidhur situatën e konfliktit të interesit në të cilën gjendej, duke filluar nga hyrja në fuqi e ndryshimeve në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” [ligji nr. 9367/2005 me ndryshimet nga ligji nr. 44/2014, datë 24.04.2014]? Dispozitat ndryshuese e konfirmojnë qartë këtë detyrim.
4. Me ndryshimet e nenit 21, pika 1 të ligjit, që hyri në fuqi më 03.06.2014, në mënyrë të shprehur u përfshinë edhe gjyqtarët e prokurorët e shkallës së parë dhe të apelit në rrethin e individëve të cilëve, me hyrjen në fuqi të ligjit, nuk u lejohej lidhja e kontratave/nënkontratave me institucione publike. Dispozita në fjalë parashikon:

“[...] Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, *gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit*, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik [...]”.
5. Ligji përcakton edhe mënyrën e veprimit për zyrtarët që gjenden në situatën e konfliktit të interesit. Nenet 37 dhe 38 përcaktojnë hapat që duhet të ndjekin zyrtarët të cilët duan të qëndrojnë në të njëjtin funksion, si në rastet kur janë në gjendje të mënjanojnë apo zgjidhin *paraprakisht* konfliktin e interesit, ashtu edhe në rastet kur për shkak të rrethanave gjenden në

situatë faktike, duke i udhëzuar se si duhet të veprojnë për të ndalur situatën e konfliktit të interesit. Në grupin e dytë,

ndër të tjera, do të duhet të ishte përqendruar po ashtu analiza për situatën në të cilën ndodhej subjekti i rivlerësimit, i cili me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2014, kishte një kontratë qiraje me {***}, Bashkia Vlorë. Në rrethanat faktike të fundit, neni 38 i ligjit parashikon një periudhë kohore brenda së cilës zyrtari merr masa të ndërpresë ushtrimin e veprimtarive të ndaluara dhe të kërkojë çregjistrimin e veprimtarive, sipas ligjit.

6. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti, duke filluar nga data 03.06.2014 e në vazhdim, përfshirë edhe gjatë procesit të rivlerësimit, ka qenë në shkelje të dispozitave të ligjit dhe nuk rezulton të ketë ndërmarrë hapa për ta ndërprerë apo mënjanuar konfliktin e interesit. Argumentet e subjektit se ligji nuk ka fuqi prapavepruese apo që kjo sipërfaqe toke ishte me vlerë financiare të papërfillshme, janë alogjike.
7. Së pari, sepse ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht dhe përjashtimisht detyrimet që hyjnë në fuqi veçmas nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit. Ligji ndryshues [nr. 44/2014] nuk përmban dispozita përjashtimore apo kalimtare lidhur me detyrimet. Sipas leximit logjik, kjo nënkupton që ligji dhe detyrimet e tij për zbatuesit hyjnë në fuqi bashkërisht në datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, që në rastin konkret ishte data 03.06.2014. Ligjvënësi ka parashikuar rastet specifike në të cilat detyrimet që lindin hyjnë në fuqi më vonë, në nenin 47. Në ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9367/2003, ligjvënësi ka pasur rregullime specifike dhe afat për zyrtarët për ta zbatuar ligjin e ri në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006. Po ashtu, sjell në vëmendje se asnjë nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9367/2005, nuk ka prekur detyrimet e neneve 37 dhe 38 që parashikojnë detyrimet e zyrtarëve, përfshirë në rastin konkret edhe subjektin e rivlerësimit, për të mënjanuar apo zgjidhur situatën e konfliktit të interesit¹²⁶.
8. Së dyti, ligji nuk e kushtëzon ekzistencën e konfliktit të interesit në formën e kontratave me institucionet publike me një vlerë të caktuar monetare. Si rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar në ligj. Nuk janë të bazuara as argumentet e tjera të subjektit se palë e interesuar ishte {***}, Bashkia Vlorë, e cila duhej të kishte ndërmarrë veprime, apo që mungon reagimi institucional, apo që mungon interesi në marrjen e tokës me qira e, për pasojë, mungon konflikti i interesit. Siç u shtjellua më sipër, subjekti ishte palë e interesuar personalisht, në cilësinë e tij si zyrtar deklarues, të ndërmernte hapa që të zgjidhte situatën e konfliktit të interesit. Më tej, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë kërkuar orientim institucional për veprimet që duhet të ndërmernte ai në funksion të zbatimit të ndryshimeve që ka pësuar ligji, sipas përcaktimeve të neneve 6 dhe 37, pikat 2 dhe 9, duke u këshilluar me eprorët apo institucionet eprorë, apo duke njoftuar e kërkuar udhëzime nga ILDKPKI-ja. Së fundmi, pretendimi se marrëdhënia e qirasë

¹²⁶ Neni 7 i ligjit nr. 86/2012, datë 18.09.2012, ka ndryshuar nenin 37 duke ofruar më shumë mënyra të zgjidhjes së konfliktit të interesit, përpos atyre të përshkruara në ligj, si vijon: "[...] Në pikën 1, në fund të shkronjës "b" shtohen fjalët: "ose, në rastin e organit kolegjial, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt." 2. Në fund të pikës 9 shtohet fjalia me këtë përmbajtje: "Zyrtari, eprori ose institucioni epror njoftojnë, në çdo rast, Inspektoratin e Lartë për masat e marra për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave [...]".

nuk shoqërohet me asnjë interes, është jobindës pasi sfidon logjikën e thjeshtë ekonomike. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti ndodhet në gjendje të vazhdueshme konflikti interesi, duke filluar nga mesviti 2014, vlerësoj se ky fakt duhet të ishte pjesë e vendimmarrjes së trupit gjykues të Kolegjit.

B. Cenimi i besimit të publikut

9. Vlerësoj që edhe lidhjet e subjektit të rivlerësimit me dy individë të identifikuar si të përfshirë në veprimtari kriminale, parë në tërësi me ekzistencën e konfliktit të interesit të shtjelluar më sipër, duhet të përbënin shkak për të gjetur cenim të besimit të publikut. Së pari, në parim, shoqërimi qoftë edhe episodik i një magjistrati me individë të cilët kanë probleme me drejtësinë, është përtej çdo argumenti një qasje që lë shumë pak vend për besim te drejtësia në një komunitet. Në këtë vlerësim, theksoj edhe mungesën e sinqeritetit të treguar nga subjekti, në fazat e hershme të hetimit administrativ ku ai mohoi njohjen me F. D. Më pas, vetëm pasi u pyet direkt, subjekti i rivlerësimit e pranoi njohjen prej vitesh të këtij personi, ilustruar edhe me njohjen e nofkave të ndryshme¹²⁷ me të cilat njihej, për shkak të prejardhjes nga e njëjta lagje e Vlorës.
10. Duke abstraguuar nga pyetja nëse subjekti ishte në kushtet e dorëheqjes nga çështja penale e vitit 2011, që është regjistruar në emër të këtij individ [pasuar nga ndjekje penale të tjera, përfshirë edhe ato për vepra që lidhen me krimin e organizuar¹²⁸], subjekti i rivlerësimit ka pranuar njohjen me këtë individ vetëm kur është pyetur në mënyrë direkte nga Komisioni. Është alogjike të pranohet se subjekti, për shkak të karrierës së tij si oficer i policisë gjyqësore dhe më pas si prokuror në rrethin gjyqësor të qytetit ku ka jetuar shumicën e jetës së tij, të mos kishte dijeni për figurën e individëve me të cilët zgjidhte të fliste në telefon apo të takohej qoftë edhe për periudha të kufizuara kohore, me të cilët njihej që në fëmijëri. Duke pasur parasysh përplasjet me ligjin të z. F. D. në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, sjellja e subjektit përbën neglizhencë profesionale dhe sjellje që nuk kontribuon në krijimin apo forcimin e besimit të publikut te një magjistrati që nuk i kushton vëmendje dhe kujdes figurës së personave me të cilët komunikon apo takohet.
11. Subjekti u tregua i pasinqertë edhe për sa i përket lidhjes me E. M. dhe natyrën e njohjes së tij me të. Dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ tregoi që subjekti kishte përdorur automjetin e këtij individ dhe ishte në shoqërinë e tij gjatë një udhëtimi jashtë Shqipërisë. Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, E. M. përbën kontakt të papërshtatshëm vetëm pas procedimit të tij penal për vepra që përfshihen në krimin e organizuar, në vitin 2016¹²⁹. Nga ana tjetër, në kontrast me detyrimin për të qenë bashkëpunues dhe i sinqertë, subjekti zgjodhi të mohonte njohjen, pretendoi fakte e rrethana të ndryshme, e përfundimisht argumentoi mungesë

¹²⁷ Sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti më datë 29.03.2019, rezultateve të hetimit administrativ.

¹²⁸ Shih edhe: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.3-date-07.02.2019-subjekti-i-rivleresimit-Shkelzen-Selimi-per-publikim-2.pdf>, paragrafi 61 e në vazhdim.

¹²⁹ Shih: <https://spak.al/2020/01/20/prokuroria-e-posacme-kunder-korrupsionit-dhe-krimin-te-organizuar/>

përgjegjësie, pasi u përball me dokumentacionin që tregonte udhëtimin e tij jashtë Shqipërisë me këtë individ, gjatë fundjavës që përkonte me ditëlindjen e tij.

12. Duke abstraguuar nga logjika e thjeshtë që procedimi penal i vitit 2016 për E. M., për vepra të natyrës së krimit të organizuar, ku përfshihen dhjetëra të dyshuar [63 vetë, sipas njoftimit zyrtar të Prokurorisë së Posaçme], duhet të jetë produkt hetimesh e veprimesh procedurale që kërkojnë kohëzgjatje të konsiderueshme, sjell në vëmendje se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën si prokuror në Fier, në periudhën mes shtatorit 2015 deri në shkurt 2016¹³⁰, gjë që e bën shpjegimin e tij për mungesë njohurie apo mungesë kohe për të qenë i informuar për përplasjet me ligjin të z. E. M., të pasinqertë dhe jobindës. Sjell në vëmendje se gjatë procesit të hetimit administrativ për procesin e rivlerësimit të subjektit, z. E. M. ka vazhduar të jetë pjesë e procedimit penal për vepra të krimit të organizuar. Duke pasur parasysh publicitetin që passjellin procedimet penale për vepra të krimit të organizuar për publikun në tërësi e në veçanti për zyrtarët, përfshirë prokurorët, për të cilët ndjekja penale përbën detyrën e tyre të përditshme, dhe faktin që subjekti i rivlerësimit pranoi që njihet me këtë person, zgjedhja e tij për të kaluar kohë me të e më pas mungesa e reflektimit për rrethanat që sollën në shoqërimin e tij, një prokurori karriere, me individë me probleme me ligjin dhe marrja e masave, përfshirë edhe mungesën e sinqeritetit në proces, përbëjnë rrethana që nuk përputhen me standardet e sjelljes që passjellin besim të publikut te drejtësia. Për këto arsye, jam e mendimit që është i bazuar konkluzioni i Komisionit për rrethana që cenojnë besimin e publikut dhe zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 në rastin e këtij subjekti rivlerësimi.

Gjyqtare

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

¹³⁰ Sipas dokumentacionit të administruar në fashikull, subjekti i rivlerësimit është komanduar në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Fier më datë 31.08.2015, me urdhrin nr. {***} të po së njëjtës datë të Prokurorit të Përgjithshëm, transferuar zyrtarisht po aty me Dekret të Presidentit nr. {***}, datë 09.10.2015, në të njëjtën prokurori. Ky emërim ka vazhduar deri në komandimin e tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor në Sarandë, duke filluar nga 22.02.2016 [me urdhrin nr. {***}, datë 19.02.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm].